

PAULO COELHO  
**SHKELJA E KURORËS**  
ROMAN

---

BOTIMET TOENA

*Libra nga Paulo Coelho,  
prej Shtëpisë Botuese TOENA*

- Alkimisti
- Mali i pestë
- Veronika vendos të vdesë
- Djalli dhe zonjusha Prym
- Pelegrini i Kompostelës
- Manuali i luftëtarit të dritës
- Njëmbëdhjetë minuta
- Zahiri
- Shtriga e Portobelos
- Buzë lumit Piedra u ula dhe qava
- Fitimtari është i vetëm
- Brida
- Alef
- Shkelja e kurorës



Paulo COELHO

# Shkelja e kurorës

---

■ *roman* ■

---

*Përktheu nga origjinali portugalisht:*  
Ilirjana Agalliu

BOTIMET TOENA  
Tiranë, 2015

Titulli në original: Paulo Coelho, Adultério

Ky libër u botua sipas marrëveshjes me  
Sant Jordi Asociados Agencia Literaria S.L.U., Barcelona (Spain).  
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.  
[www.santjordi-asociados.com](http://www.santjordi-asociados.com)

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo  
Korrektore letrare: Majlinda Bami  
Përkujdesja grafike: Elida Stafa  
Kopertina: Albana Kuraj

ISBN 978-9928-4277-2-4

© 2014 Paulo Coelho  
(<http://paulocoelhoblog.com>)  
© 2015 *Në gjuhën shqipe*: Shtëpia Botuese Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi i materialeve që përmban ky libër me asnjë mjet apo formë, as me fotokopje, as pjesërisht, pa lejen me shkrim të Botimeve Toena.

Botimet TOENA

Rr. "M. Gjollësia", K. Postare 1420, Tiranë  
Tel.: ++355 4 22 40 116; ++355 4 22 58 893  
Fax: ++355 4 22 40 117  
E-mail: [redaksia@toena.com.al](mailto:redaksia@toena.com.al)  
[botimet.toena@gmail.com](mailto:botimet.toena@gmail.com)  
[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

*O Shën Mëri, mbarsur pa mëkat  
Lutu për ne që pas teje të vijmë,  
Amin!*

*“Shko atje ku ujërat janë më të thella...”*

LUKAS, 5:4

Çdo mëngjes, kur hap sytë për të parë atë çka e quajnë “ditë e re”, kam dëshirë t’i mbyll sërish e të mos çohem nga shtrati. Gjithsesi duhet bërë.

Kam një burrë të mrekullueshëm, tejet i pasionuar pas meje, pronar i një fondi të konsiderueshëm investimesh dhe që çdo vit, edhe pa dëshirën e tij, figuron tek revista *Bilanc*, në listën e treqind njerëzve më të pasur në Zvicër.

Kam dy fëmijë që janë “motivi i jetës” sime (sikurse thonë shoqet e mia). Herët në mëngjes duhet t’u jap të hanë, të bëj kafënë dhe të çoj fëmijët në shkollë, e cila ndodhet pesë minuta më këmbë larg shtëpisë. Ata qëndrojnë atje me kohë të plotë, çka më lejon të punoj dhe të kem kohë edhe për vete. Pas mësimit, kemi një dado filipinase që kujdeset për ta deri sa të kthehemi unë dhe im shoq në shtëpi.

Më pëlqen puna që bëj dhe jam gazetare e njohur në një gazetë prestigjioze, të cilën mund ta gjesh në çdo cep të Gjenevës, ku edhe jetojmë.

Një herë në vit kaloj pushimet bashkë me familjen, përgjithësisht në vende të bukura si parajsë e natyrës, me plazhe të mrekullueshëm, në qytete “ekzotike”, por me popullsi të varfër, gjë që na bën të ndihemi edhe më të pasur, të privilegjuar e mirënjohës për të mirat që na ka dhënë jeta.

Ende nuk jam prezantuar. Quhem Linda, 31 vjeç, e gjatë 1,75 m, 68 kile dhe vishem me rroba nga më të mirat (falë bujarisë së pakufishme të burrit tim). Ngjall dëshirë tek burrat dhe zili tek gratë.

Ndërkohë, çdo mëngjes, kur çel sytë në këtë botë ideale, që shumë e ëndërrojnë dhe pak e arrijnë, unë e di se dita do të jetë e mërzitshme. Deri këtë fillim viti nuk e pyesja veten për asgjë, veç vijoja jetën time, edhe pse herë pas here ndihesha me faj që kisha më shumë se sa meritoja. Një ditë të bukur, teksa përgatitja mëngjesin për të gjithë (më kujtohet që ishte pranverë dhe lulet kishin filluar të çelnin në kopsht) e pyeta veten: “Kaq ishte e tëra?”

Nuk duhet ta kisha bërë këtë pyetje. Fajin ma pati një shkrimtar që kisha intervistuar një ditë më parë, i cili në një çast më tha:

- Nuk jam aspak i interesuar të jem i lumtur; preferoj të jetoj pasionin, çka është me rrezik, pasi nuk e dimë kurrë se me çka do të përballemi.

Pra, mendova, ky i shkretë nuk qenka kurrë i kënaqur dhe do të vdesë i trishtuar e buzëplasur.

Të nesërmen e kuptova se mua nuk më rrezikonte asgjë. E di se çfarë më pret: një tjetër ditë si e djeshmja. E dashuruar? Mirë pra, unë e dua tim shoq, çka është një garanci se nuk do të bie në depresion, siç ndodh, kur jeton e detyruar nga kushtet financiare, për hir të fëmijëve apo për sytë e botës.

Jetoj në vendin më të sigurt të botës, të gjitha i kam në rregull dhe jam nënë dhe bashkëshorte e mirë. Kam marrë një edukatë të fortë protestante dhe mendoj t'ua transmetoj këtë edhe fëmijëve. Nuk hedh asnjë hap të gabuar, sepse e di që mund të prish gjithçka. Gjërat i bëj me efikasitet maksimal, por duke u përfshirë sa më pak personalisht. Kur isha e re fare vuaja për dashuriçkat pa përgjigje, sikurse çdo njeri normal.

Por me t'u martuar, koha ndali në vend.

Kështu ishte deri sa takova atë shkrimtarin e mallkuar dhe mora përgjigjen e tij.

E ç'të keqe ka rutina apo mërzia?

Për të qenë e sinqertë, absolutisht asgjë. Vetëm se ...vetëm ajo frika sekrete se mos gjithçka ndryshon papritur duke më kapur krejt të papërgatitur.

Që nga çasti që pata këtë mendim të keq, në një mëngjes të mrekullueshëm, fillova të kem frikë. A

do të isha e zonja ta përballoja jetën vetëm nëse vdiste im shoq? Po, u përgjigja me vete, sepse trashëgimia e tij do të ishte e mjaftueshme për të mbajtur disa breza. Po sikur të vdes unë, kush do të kujdeset për fëmijët e mi? Sigurisht që burri im i dashur. Por ai do të martohet me një tjetër, sepse është edhe i pasur, i pashëm dhe inteligjent. Pra, në ç'duar do të jenë fëmijët e mi?

Hapi im i parë ishte që t'u jepja përgjigje gjithë dyshimeve të mia. Dhe, sa më shumë përgjigjesha, aq më shumë pyetje dilnin. Mos vallë ai do të gjejë ndonjë dashnore kur të plakem unë? Mos vallë e ka gjetur, duke qenë se edhe dashuri nuk bënim më si dikur? Mos ndoshta ai mendon se unë kam dikë tjetër, prandaj edhe nuk jam treguar shumë e interesuar në tre vitet e fundit?

Kurrë nuk jemi grindur prej xhelozisë dhe këtë e gjykoja si diçka të mirë, por që nga ai mëngjes pranveror fillova të dyshoj që kjo nuk është tjetër veç mungesë e dashurisë nga të dyja palët.

Bëra ç'ishte e mundur të mos e mendoja më këtë çështje.

Një javë rresht dilja nga puna dhe shkoja të blija diçka në Rue de Rhône, rrugën Ron. Nuk ishte se më interesonte ndonjë gjë, por le të themi që kisha ndjesinë se po ndryshonte diçka, pasi po ndieja nevojën për një artikull që më parë nuk e



kisha menduar. Zbuloja ndonjë pajisje elektrike shtëpie, të cilën nuk e dija se ekzistonte, ndonëse në këtë fushë vështirë se ka shpesh gjëra të reja për të zbuluar. I shmangia dyqanet për të vegjlit që të mos i llastoja fëmijët e mi me dhurata vend e pa vend. Nuk hyja as në dyqanet për burra, që im shoq të mos dyshonte për ndonjë zemërgjerësi të tepruar nga ana ime.

Kur kthehesha në shtëpi dhe hyja në atë mbretërinë e këndshme të botës sime private, për nja tri apo katër orë gjithçka dukej e mrekullueshme, madje deri sa të gjithë binin për të fjetur. Pikërisht në këtë kohë, pak e nga pak, më fillonte makthi.

Mendoja se pasioni ishte për të rinjtë dhe se mungesa e tij në moshën time ishte diçka normale. Pra, nuk është kjo që më tremb.

Sot, pasi kanë kaluar disa muaj, jam një grua e dyzuar mes frikës se mos ndryshon gjithçka dhe asaj se mos vazhdon gjithnjë po kështu deri në fund të jetës sime. Disa thonë se, kur afron vera, na lindin ide disi të çuditshme, madje ndihemi më të vegjël, pasi kalojmë më shumë kohë në mjedise të hapura në natyrë dhe kjo na jep përmasat e botës që na rrethon. Horizonti duket më i largët, me gjithë retë në qiell dhe muret e shtëpisë.

Ndoshta. Por unë nuk po fle mirë dhe shkakun nuk është të nxehtit. Kur bie nata e nuk më sheh

njeri, unë kam frikë nga gjithçka: nga jeta, nga vdekja, nga dashuria, si dhe nga mungesa e saj, nga fakti se çdo gjë e re bëhet e zakonshme, nga ndjesia se po humbas vitet më të mira të jetës sime në një rutinë që do të vazhdojë sa të jem gjallë, si dhe nga paniku për t'u përballur me të panjohurën, sado ngacmuese apo aventureske qoftë.

Natyrisht, përpiqem të ngushëllohem me hallet e të tjerëve si puna ime. Ndez televizorin dhe ndjek çfarëdo buletin lajmesh, shoh lajme të shumta për aksidente, për të pastrehë si pasojë e fatkeqësive natyrore, për refugjatë të shumtë. Sa të jetë numri i të sëmurëve në tërë planetin vallë? Sa janë ata që vuajnë në heshtje dhimbje ulëritëse, padrejtësi apo tradhti? Sa të varfër, të papunë e të burgosur të ketë vallë?

Endërroj kanalin televiziv dhe humbas mendjen me një telenovelë apo film për disa minuta apo orë. Vdes nga frika se mos zgjohet im shoq e më pyet: “Çfarë ke e dashur?” E di se do të duhej të përgjigjesha se gjithçka është në rregull. Madje edhe më keq do të ish - sikurse ndodhi dy a tri herë muajin e kaluar - sikur sapa të biem në shtrat, ai të vendoste dorën mbi kofshën time, pastaj të shkojë më tej e të më ngacmojë. Mund edhe të shtirem sikur jam në qejf, se e kam bërë këtë disa herë, por nuk arrij dot të eksitohem deri në orgazëm.

Do të më duhej t'i thosha se jam e rraskapitur, ndërsa ai, pa më rënë kurrë në sy se i mbeti hatri, do të më jepte një puthje dhe do të kthehej në anën tjetër për të parë lajmet e fundit në tabletën e tij, teksa do të priste të nesërmen. Ndërkohë, unë do të vdisja nga dëshira që ai të vinte i lodhur, shumë i lodhur.

Por nuk ndodh kështu gjithmonë. Herë pas here, më duhet të marr iniciativën. Nuk mund ta refuzoj dy herë rresht se ai do të kërkonte ndonjë dashnore dhe nuk dua në asnjë mënyrë që ta humbas. Me pak masturbim arrij të lagem më parë dhe pastaj gjithçka kthehet në normalitet.

“Gjithçka kthehet në normalitet” do të thotë: asgjë nuk do të jetë si më parë, si në kohën kur ndaj njëri-tjetrit kishte ende mister.

Të arrish të ruash të njëjtin zjarr edhe pas dhjetë vite martesë më duket anomali. Madje, sa herë që shtirem se kam kënaqësi në seks, ndiej se vdes nga pak përbrenda. Pak? Më duket se po shteroj më shpejt se sa e kisha menduar.

Shoqet e mia mendojnë se jam me fat, kur u them, duke i gënjyer, që bëj seks herë pas here, ashtu siç nuk janë të sinqerta edhe ato kur thonë që nuk e marrin vesh se si burrat e tyre ruajnë gjithmonë të njëjtin tërheqje për to. E pohojnë se seksi në çift jep kënaqësi vetëm në pesë vitet e para,

ndërsa në vazhdim duhet pak “fantazi”. Mbyll sytë dhe përfytyro sikur fqinji yt është me ty, bën gjëra që yt shoq nuk do të guxonte kurrë. Mendo sikur i ke të dy njëherësh, burrin dhe atë, dhe bën të gjitha prapësitë e mundshme dhe të gjitha lojërat e ndaluara.

Sot, kur dola për të çuar fëmijët në shkollë pashë fqinjin tim. Asnjëherë nuk e kisha përfytyruar sipër meje - parapëlqej të mendoj për një reporter të ri, i cili punon me mua dhe që ka gjithmonë pamjen e të përvuajturit, të vetmitarit. Kurrë nuk e kam parë të përpiqet të joshë dikë dhe pikërisht këtu qëndron edhe sharmi i tij. Të gjitha gratë e redaksisë kanë komentuar, herë pas here, se do të donin të “kujdeseshin disi për të shkretin”. Besoj se edhe ai është i vetëdijshëm për këtë dhe kënaqet me të qenit thjesht një objekt dëshire e asgjë më tepër. Ndoshta ndien po ashtu si unë: frikë të tmerrshme për të hedhur një hap para se mos prish gjithçka - punën, familjen, të shkuarën dhe të ardhmen e vet.

Por në fund të fundit... E vështrova mirë fqinjin tim këtë mëngjes dhe ndjeva një dëshirë të madhe për t'ia plasur të qarit. Ai po lante makinën e tij dhe unë mendova: ja edhe një tjetër si im shoq

e si unë. Një ditë do ta bëjmë edhe ne të njëjtën gjë. Fëmijët do të jenë rritur dhe do të ndërrojnë qytetin apo vendin, ndërsa ne si pensionistë do të lajmë makinat tona - ndonëse i kemi mundësitë të paguajmë dikë për ta bërë këtë punë. Ndërkaq, kur ke një farë moshe, është e rëndësishme të bësh ca gjëra që bien në sy teksa kalon kohën e lirë, pasi kështu u tregojmë të tjerëve se kemi një trup që funksionon ende mirë, se nuk e kemi humbur nocionin e parasë dhe se vazhdojmë t'i kryejmë disa detyra me thjeshtësi.

Një makinë e pastruar nuk u bën ndonjë përshtypje të madhe të tjerëve, por këtë mëngjes ishte e vetmja gjë që kish rëndësi për fqinjin tim. Tek më vuri re, ai më uroi një ditë të mbarë, buzëqeshi dhe iu kthye punës së vet, sikur të ishte duke u përkujdesur për një skulpturë të Rodenit.

**E** parkova makinën tek një stacion - “Përdorni transportin publik deri në qendër! Ndal ndotjes së mjedisit!” - Marr autobusin si gjithnjë dhe vështroj të njëjtat pamje deri në puna. Gjeneva duket sikur nuk ka ndryshuar fare qëkurse isha fëmijë: shtëpi të mëdha luksoze që këmbëngulin të jetojnë mes ndërtimeve të lejuara nga ndonjë prefekt i marrë që paskësh zbuluar “një arkitekturë të re” në vitet ’50.

Sa herë që udhëtoj jashtë vendit, ia ndiej mungesën gjithë kësaj. Ja, kësaj shije arkitekture tmerrësisht të keqe, ku mungojnë kullat prej çeliku e qelqi, apo edhe rrugë të drejta fare, këtyre rrënjëve të dala të pemëve që lëvizin gurët e kalldrëmeve e na bëjnë të kërcejmë herë pas here ndërsa ecim në to, parqeve publike me rrethimet e drunjta ku mbin çdo lloj barishteje, pasi “natyra është e tillë”... Në fund të fundit, një qytet ndryshe nga gjithë të tjerët që u modernizuan dhe humbën magjinë e tyre.

Këtu ende themi “mirëdita” kur takojmë një të panjohur në rrugë, si dhe “mirupafshim” kur dalim nga dyqani ku blejmë qoftë edhe vetëm një shishe ujë mineral, ndonëse nuk kemi ndër mend të kthehemi më atje. Ende flasim me të panjohurit në autobus, edhe pse pjesa tjetër e botës mendon se zviceranët janë të matur e të mbyllur.

Ç’ide e gabuar! Por më mirë që mendojnë kështu, se në këtë mënyrë ne ruajmë mënyrën tonë të jetesës edhe për nja pesë a gjashtë shekuj, para se të kapërcejnë Alpet pushtimet barbare me pajisjet e tyre elektronike, me dhomat e vogla dhe sallonet e mëdhenj për t’i lënë pa fjalë të ftuarit, me gratë me shumë makijazh, burra që flasin me zë të lartë dhe shqetësojnë fqinjët, si dhe me adoleshentët që vishen si rebelë, por vdesin nga frika se ç’do të thotë nëna apo babai.

Lërinin të tjerët të mendojnë se nuk kemi bërë tjetër gjë, përveç se kemi rritur lopë dhe kemi prodhuar djathë, çokollata të mira, si dhe orë. Le të mendojnë se në çdo rrugicë të Gjenevës ka nga një Bankë. Nuk na intereson aspak ta ndryshojmë këtë vizion. Jemi të lumtur pa pushtimet barbare. Jemi të gjithë të armatosur deri në dhëmbë - meqë shërbimi ushtarak është i detyrueshëm dhe çdo zviceran e ka një pushkë në shtëpi - ndonëse



rrallëherë mund të dëgjohet se dikush vendosi të qëllojë mbi tjetrin me armë.

Jemi të lumtur që prej shekujsh nuk kemi ndryshuar gjë dhe ndihemi krenarë që kemi qëndruar të paanshëm, teksa Europa i niste bijtë e saj në luftëra pa kuptim. Na gëzon fakti që nuk jemi të detyruar t'i japim shpjegime askujt për pamjen pak tërheqëse të Gjenevës, me ato kafenetë si në fund të shekullit XIX dhe zonjat e moshuara që ecin rrugëve rehat-rehat.

“Jemi të lumtur”, ndoshta kjo do të ishte një deklaratë e rreme. Të gjithë janë të lumtur, përveç meje, që në këtë moment po shkoj në punë duke menduar se çfarë nuk shkon tek unë.

Një ditë tjetër dhe, si gjithmonë, sërish gazeta kërkonte të gjenim lajme interesante për botim, përveç atyre të zakonshme mbi aksidentet automobilistike, për grabitje (jo nën kërcënimin me armë), si dhe për zjarret (ku shkojnë dhjetëra makina me personel shumë të kualifikuar që kontrollojnë qoftë edhe një apartament të vjetër kur tymi nga diçka e pjekur dhe harruar në furrë ka trembur gjithë njerëzit).

Kthimi sërish në shtëpi, kënaqësia e gatimit, shtrimi i tavolinës dhe familja mbledhur rreth saj, duke u lutur e falënderuar Zotin për ushqimi që kemi. Një tjetër mbrëmje, pas buke, ku secili zë qoshen e vet - babai ndihmon fëmijët për detyrat e shtëpisë, nëna merret me pastrimin e kuzhinës për ta lënë atë të pastër, shtëpinë gati, si dhe paratë për punëtooren që vjen në mëngjes herët.

Gjatë këtyre muajve pati momente kur jam ndjerë vërtet mirë. Mendoj se jeta ime ka kuptim,

se ky është roli i qenies njerëzore në Tokë. Fëmijët e kuptojnë që nëna është e qetë, burri është më i sjellshëm e i vëmendshëm, dhe tërë shtëpia duket sikur ka dritë vërtet. Jemi shembulli i lumturisë për banorët e tjerë të rrugës sonë, qytetit, shtetit, të cilin e quajmë - kanton, vendit.

Dhe menjëherë, pa asnjë arsye të shpjegueshme, hyj në dush e shpërthej në lot. Qaj në banjë se këtu askush nuk e dëgjon dënesën time dhe të më bëjë pyetjen, të cilën nuk dua ta dëgjoj: “Mirë i ke punët?”

Po, pse të mos i kem? A shihni ndonjë gjë që nuk shkon në jetën time?

Asgjë fare.

Veçse më frikëson nata.

Dita nuk më fal asnjë kënaqësi.

Imazhe të lumtura të së shkuarës dhe gjëra që mund të ishin bërë e që nuk u bënë.

Dëshira për aventurë, e pa realizuar kurrë.

Frika se çfarë mund t’u ndodhë fëmijëve të mi.

Dhe ndërkohë, mendimi fillon të vërtitet rreth gjërave negative, sikur një demon të përgjonte në qoshe të dhomës, për të m’u hedhur më pas duke më thënë se ajo që unë e quaja “lumturi” ishte veç një gjendje kalimtare, e cila nuk mund të zgjatë shumë. Ti e ke ditur gjithmonë këtë, apo jo?

Dua ndryshim. Kam nevojë për ndryshim. Sot në punë u tregova më e acaruar se zakonisht, vetëm se një stazhier u vonua për gjetjen e materialit që i kërkova. Nuk jam kështu, por pak nga pak po humbas kontaktin me veten time.

Është budallallëk të fajësoj atë shkrimtarin dhe intervistën me të. Që atëherë kanë kaluar muaj. Ai vetëm sa i hapi grykën një vullkani që ishte gati të shpërthente në çdo moment, për të mbjellë vdekje e shkatërrim rreth e rrotull. Po të mos ishte ai, do të bëhej shkak një film, një libër apo dikush me të cilin do të shkëmbeja dy a tri fjalë. Mendoj se disa kalojnë vite dhe e lënë që të rritet presioni brenda tyre, pa e kuptuar as ata vetë, deri sa një ditë prej ditësh e humbasin mendjen për diçka fare të vogël.

Atëherë thonë: “Mjaft! Nuk e dua më këtë!”

Disa vriten, të tjerë ndahen, ndërkohë që ka edhe nga ata që nisen për në zonat e varfra të Afrikës për të shpëtuar botën.

Por unë e njoh mirë veten time. E di që reagimi im i vetëm do të ishte që ta mbysja ndjenjën, deri sa një kancer të më gërryente përbrenda, sepse besoj vërtet që një pjesë e madhe e sëmundjeve vjen nga ndrydhja e emocioneve.

**M**ë del gjumi në orën dy të mëngjesit dhe rri e vështroj tavanin, edhe pse e di që të nesërmen duhet të ngrihem herët - gjë që e urrej vërtet. Në vend që të mendoja për diçka produktive, si “çfarë po ndodh me mua”, unë nuk po arrij as të kontrolloj mendimet. Ka madje ditë - ndonëse falë Zotit janë të rralla - që e pyes veten nëse duhet të shkoj në ndonjë spital psikiatrik për të kërkuar ndihmë. Ajo çka më pengon ta bëj këtë nuk është puna dhe as im shoq, por janë fëmijët. Ata, në asnjë mënyrë, nuk mund ta kuptojnë se çfarë ndiej.

Gjithçka rrjedh me më shumë intensitet. Kthehem e mendoj për martesën - këtë timen - ku xhelozia nuk ishte kurrë pjesë e një debati. Por ne gratë kemi një shqisë të gjashtë. Ndoshta im shoq ka gjetur dikë tjetër dhe unë e perceptoj këtë në mënyrë të pandërgjegjshme. Ndërkaq, nuk ka asnjë arsye që të kem dyshime për të.

A nuk është absurde? A thua që, mes gjithë burrave të kësaj bote, qenkam martuar me të vetmin burrë që është i përkryer? Nuk pi, nuk rri natën jashtë, nuk ka asnjë ditë takimi fikse me shokët e tij. Jeta e tij përmbledhet vetëm tek familja.

Do të ishte një ëndërr, në mos qoftë makth, sepse përgjegjësia ime për t'iu përgjigjur në po atë lartësi bëhet tepër e madhe.

Atëherë e kuptoj se fjalë si “optimizmi” dhe “shpresa”, që lexojmë në çdo libër, i cili synon të na përgatitë për të qenë të sigurt në jetë, nuk qenkan veçse pallavra. Dijetarët që i shqiptuan, ndoshta kërkonin një kuptim për këto fjalë dhe na përdorën si kavje, për të parë se si do të reagonim ndaj këtij stimuli.

Në fakt, ndihem e lodhur nga një jetë e lumtur dhe e përkryer, dhe kjo mund të jetë shenjë e ndonjë sëmundjeje mendore.

Duke menduar kështu më merr gjumi. Kush e di, mos kam ndonjë problem serioz?

**D**o të drekoj me një shoqe.

Ajo më sugjeroi të takohemi tek një restorant japonez që nuk e kisha dëgjuar kurrë, çka është e çuditshme, sepse mua më pëlqen shumë kuzhina japoneze. Më siguroi se ndodhet në një vend të mrekullueshëm, ndonëse pak larg vendit të punës.

Nuk ishte e lehte të shkoje dhe m'u desh të merrja dy linja autobusi e të pyesja dikë në rrugë, që të më tregonte galerinë ku ndodhej "restoranti i shkëlqyer". Gjithçka m'u duk e shëmtuar - dekorimi, tavolinat me mbulesa letre, gjysmerrësira në të. Por shoqja ime ishte e sigurt se do të hanim më mirë se kudo në Gjenevë.

- Unë haja gjithmonë në të njëjtët restorante që më dukeshin të mirë, por jo të veçantë - më tregon ajo. - Kështu deri sa një ditë një miku im që punon në Misionin Diplomatik të Japonisë më sugjeroi këtë restorant. Fillimisht m'u duk një

vend i shëmtuar, siç t'u duk ndoshta edhe ty, por janë pronarët që shërbejnë këtu dhe kjo përbën veçorinë e tij.

Unë po ashtu shkoj në të njëjtët restorante dhe kërkoj po ato pjata, më duket. As për kaq nuk jam në gjendje të rrezikoj.

Mikesha ime pi ilaçe kundër depresionit, por kjo nuk bën pjesë në bisedën tonë të sotme, sepse kam arritur në përfundimin se edhe vetë jam një hap larg kësaj sëmundjeje dhe nuk dua ta pranoj.

Pikërisht atë që mendoja se do të ish gjëja e fundit që do të bëja, unë e bëra të parën. Tragjedia e tjetrit gjithmonë na ndihmon të zvogëlojmë vuajtjet tona.

E pyeta se si ndjehej.

- Shumë më mirë, megjithëse ilaçet nuk bënë efekt të menjëhershëm, por pas ca kohe. Gjithsesi nën veprimin e tyre, në organizëm fillon faza që kemi interesa për gjëra të ndryshme, rikthehet shija dhe ngjyra.

Me fjalë të tjera, vuajtja është kthyer në një burim fitimi për industrinë farmaceutike. Je i dëshpëruar? Merr një kokërr dhe mbyllen hallet.

E pyes me delikatesë në se është e interesuar të bashkëpunojë me gazetën për një artikull mbi depresionin.



- Nuk ia vlen. Në ditët tona njerëzit i qajnë hallet me njëri-tjetrin në internet. Gjejnë zgjidhje.

- Çfarë shkëmbejnë përmes internetit?

- Efektet anësore të ilaçeve, sepse askush nuk interesohet për simptomat e tjetrit, pasi mund të jenë ngjitëse dhe papritur fillojmë të ndiejmë diçka që nuk e kishim ndjerë më parë.

- Po tjetër?

- Ushtrime meditimi, të cilat nuk mendoj se japin shumë rezultat. I kam provuar të gjitha, por u shërova vetëm kur vendosa të pranoj se kam vërtet një problem.

- Por nëse di që nuk je vetëm ti kështu, a nuk ndihmon? Të flasësh e bisedosh se çfarë ndien në rastin e depresionit, a nuk u shërben njerëzve në përgjithësi?

- Në asnjë mënyrë. Ai që ka dalë nga ferri nuk ka më interes të dëgjojë se ç'bëhet atje brenda.

- Përse kalove vite e vite në atë gjendje?

- Sepse unë nuk e besoja që isha me depresion dhe kur flisja me ty e me shoqet e tjera, ju më thoshit se ishte budallallëk, pasi njerëzit që kanë vërtet problem nuk kanë kohë për të ndjerë depresionin.

Ishte e vërtetë që e kisha thënë një gjë të tillë.

Ngula këmbë.

- Atëherë një artikull apo një pjesë në blog ndoshta i ndihmon njerëzit që ta durojnë sëmundjen

dhe të kërkojnë ndihmë. Meqenëse unë nuk jam depressive dhe nuk e di se çfarë ndodh - theksova - a mund të më flasësh diçka për këtë?

Ajo hezitoi, por është mikështa ime dhe ndoshta dyshon për diçka.

- Është sikur të jesh në një kurth. E di që je e mbërthyer, por nuk arrin...

Ishte pikërisht kjo që kisha menduar disa ditë më parë.

Ajo më rreshtoi një listë me gjëra që duken njësoj për të gjithë ata, të cilët e kanë njohur atë që quhet "ferr". Mungesë dëshire për t'u çuar nga shtrati, ndërsa punët më të zakonshme të duket se duan përpjekje herkuliane. Ndjenja e fajit sepse nuk ka arsye fare pse të jesh në këtë gjendje, ndërkohë që shumë të tjerë në botë jetojnë në vuajtje.

Mundohem të përqendrohem tek pjata e mrekullueshme, e cila ndërkaq sikur e humbi lezetin, ndërsa mikështa ime vazhdon:

- Apati. Të shtiresh e gëzuar ose e trishtuar, apo në orgazëm, të shtiresh se po dëfrehesh, se fjete mirë, të shtiresh se po jeton, deri sa vjen një ditë që ka një linjë të kuqe imagjinare që ti e kupton se po e kalove nuk ka më kthim mbrapa. Atëherë, ndalon së ankuari, se edhe kur qahesh do të thotë se po lufton me diçka. Paskëtaj pranon gjendjen vegetative, që përpiqesh ta fshehësh para botës. Kjo ka mundim.

- Po çfarë e ka shkaktuar depresionin tënd?

- Asgjë e veçantë. Po ti pse po më pyet kaq shumë? Mos ke ndërë diçka të tillë?

- Sigurisht që jo!

Më mirë të ndërroj temë.

Fillojmë të flasim për politikë dhe se si pas dy ditësh më duhet të intervistoj një ish të dashur të shkollës së mesme, i cili ndoshta nuk më mban mend fare, pasi shkëmbyem veç dy-tri puthje dhe një prekje në gjoksin ende të paformuar që kisha.

Mikeshajme entuziazmohet, teksa unë përpiqem të mos mendoj për asgjë dhe vë frenat e reagimit në pilotin automatik.

Apatia. Ende nuk kam arritur deri aty, ndërsa jam në fazën që ankohem për çka po më ndodh, por mendoj se pas pak kohe - nuk di në janë muaj, ditë apo orë - mund të humbas interesin për gjithçka dhe këtë është vështirë ta luftosh.

Duket sikur shpirti dalëngadalë po më ikën nga trupi për të shkuar në një vend të panjohur, në një vend të "sigurt", ku nuk ka nevojë të më durojë mua dhe makthet e netëve të mia. Më duket sikur nuk jam në një restorant të tmerrshëm japonez, por me një gatim të shijshëm, dhe se gjithçka që përjetoj është veçse skenë e një filmi që po shoh, pa dashur - apo pa mundur - të ndërhyj.

**K**ur zgjohem përsërit të njëjtat rituale të përhershme - larje dhëmbësh, përgatitje e veshje për punë, zgjimi i fëmijëve, kafeja dhe mëngjesi për të gjithë, të buzëqeshësh, të thuash që jeta është e bukur. Në çdo minutë e në çdo gjest, ndiej një peshë të brendshme që nuk arrij ta identifikoj, ashtu si ajo kafsha që nuk e merr vesh se si arritën ta kapnin me çark.

Ushqimet duken pa shije, por buzëqeshja, në të kundërt, shtrihet më shumë (që të mos lësh dyshime), dëshira për të qarë gëlltitet, drita duket shkëndijë.

Ajo biseda e djeshme nuk më bëri mirë: madje kam filluar të mendoj se po i iki gjendjes së revoltës dhe po eci shpejt drejt apatisë.

A thua nuk e vë re askush?

Sigurisht që jo. Në fund të fundit, unë vetë do të isha e fundit në botë që do të pranoja se kam nevojë për ndihmë.

Ky është problemi im: vullkani shpërtheu dhe vështirë ta drejtosh sërish llavën për brenda, të mbjellësh pemë, të presësh barin e të vësh delet të kullosin atje.

Nuk e meritoja një gjë të tillë. Jam përpjekur gjithmonë të plotësoj pritshmërinë e të tjerëve ndaj meje. Por ja që ndodhi dhe nuk jam në gjendje të bëj asgjë, përveç se të pi ilaçe. Ndoshta sot saja ndonjë arsye për të bërë një artikull mbi psikiatrinë dhe sigurimet shoqërore (redaksia do ta vlerësonte shumë) dhe kështu takoj ndonjë psikiatër të mirë për t'i kërkuar ndihmë, ndonëse kjo nuk është etike. Por jo gjithçka është etike.

Nuk kam asnjë fiksion që të më ketë mbërthyer kokën - si për shembull të mbajturit dietë. Nuk kam as maninë e rregullit, që të çon kurdoherë në kërkim të metave në punën e punëtores së shtëpisë, e cila punon nga ora tetë e mëngjesit deri në pesë të pasdites, ndërkohë që edhe lan, hekuros, të pastron shtëpinë dhe bën pazarin. Nuk mund t'i shkarkoj zhgënjimet e mia duke u përpjekur të jem një super-mama, sepse fëmijët e mi do ta vuanin këtë gjithë jetën.

Nisem për në punë dhe shoh sërish fqinjin që pastron makinën e vet. Po a nuk e bëri edhe dje këtë?

Pa mundur të përmbahem iu afrova dhe e pyeta përse...

- Lashë ca gjëra pa bërë dje, - m'u përgjigj ai pasi më përshëndeti, më pyeti për fëmijët dhe lëvdoi fustanin tim.

I hodha një sy makinës së tij. Ishte një Audi (që Gjenevës i ka dhënë nofkën Audiland). Duket e përkryer. Fqinji më tregon nja dy detaje që nuk shkëlqejnë ende siç duhet.

E shtyj më tej bisedën dhe e pyes se çfarë mendon ai që kërkojnë njerëzit nga jeta.

- E thjesht fare: që të përballojnë shpenzimet, të blejnë një shtëpi, si imja apo juaja, të kenë një kopsht me pemë, të presin bijtë me nipër e mbesa ditën e diel për drekë dhe, pas daljes në pension, të bëjnë udhëtime nëpër botë.

Kaq kërkojnë njerëzit nga jeta? Vetëm kaq dashkan? Diçka nuk shkon në këtë botë dhe nuk janë veç luftërat në Azi apo në Lindjen e Mesme.

Para se të shkoj në redaksi duhet të intervistoj Jakobin, ish të dashurin tim të shkollës së mesme. As kjo nuk më bën përshtypje - po humbas interesin për çdo gjë.

**A**i më jep informacione rreth programit të qeverisë, të cilat as ia kërkoja. I drejtoj pyetje për ta zënë ngushtë, por rrëshqet me elegancë. Është një vit më i ri se unë, pra duhet të jetë 30 vjeç, ndonëse duket si 35. E ruaj për vete këtë vëzhgim timin.

Sigurisht që më vjen mirë që e takova sërish edhe pse ai, deri atë kohë, nuk më kish pyetur fare se si kishte shkuar jeta ime, qëkurse secili prej nesh ndoqi rrugën e vet pasi mbaruam maturën. Është i përqendruar tek vetja, tek karriera, tek e ardhmja, ndërsa unë jam kapur pas së shkuarës me budallallëk, sikur të isha ende ajo adoleshentja me telat në dhëmbë, megjithatë gjithnjë e parë me zili nga vajzat e shkollës.

Në një moment të bisedës, shkëpus dëgjimin dhe as nuk e ndjek më, pasi kam vënë pilotin automatik. Gjithmonë po ky avaz, të njëjtat pyetje - ulja e taksave, lufta kundër kriminalitetit, një kontroll më i mirë i kufijve për francezët, të cilët i

quajmë fqinjë, por na zënë vendet e punës që mund të ishin për zviceranët. Ikën një vit e vjen tjetri dhe temat janë po ato, pasi edhe problemet mbeten të njëjtat dhe pa u zgjidhur, se në fakt askush nuk e çan kokën për këtë.

Pas nja njëzet minutash bisedë, filloj të pyes veten nëse ky indiferentizmi im është pasojë e gjendjes sime këto kohë. Por jo. Nuk ka gjë më të mërzitshme se sa të intervistosh politikanë. Do të isha më e kënaqur të më dërgonin për të mbuluar një rast krimi. Vrasësit janë më vetvetja.

Në krahasim me përfaqësuesit e popullit në çdo vend të botës, këta tanët janë më pak interesantë e më pa kripë. Askush nuk do t'ia dijë për jetën e tyre private dhe vetëm dy aspekte çojnë në skandal: korrupsioni dhe droga. Në këtë rast buja merr dhenë e bën jehonë më shumë se sa duhet, sepse gazetatat nuk kanë ç'të shkruajnë.

Po kush do t'ia dijë në kanë apo jo të dashura, në se frekuentojnë shtëpitë publike, apo shpallin homoseksualitetin e tyre? Askush. Le të vazhdojnë punën për të cilën janë zgjedhur, të mos cenojnë fondin publik dhe jemi të gjithë në paqe.

Presidenti i vendit ndryshon çdo vit (po, kështu është...*çdo vit*) dhe nuk zgjidhet nga populli, por nga Këshilli Federal, një organizëm i përbërë nga shtatë ministra, i cili drejton Shtetin



të Zvicrës. Nga ana tjetër, sa herë që kaloj para Muzeut të Arteve të Bukura shoh lajmërimet për të tjerë referendume.

Popullit i pëlqen shumë të vendosë për gjithçka - për ngjyrën e thesit të mbeturinave, (ku fitoi e zeza), për lejimin e armëve (fitoi me shumicë votash e drejta për të mbajtur armë), ndërkohë që Zvicra është vendi me numrin më të madh të armëve për frymë në nivel botëror. Po kështu edhe për numrin e minareve në nivel kombëtar (gjithsej katër), për ligjin mbi azilin e refugjatëve (nuk e ndoqa, por ligji kaloi e duhet të jetë tashmë në fuqi).

- Zoti Jakob Konig.

Na ndërpreni intervistën, por ai me delikatesë i kërkoi sekretarit ta shtyjë takimin tjetër. Gazeta ku punoj unë është më e rëndësishmja në pjesën franceze të Zvicrës dhe intervista mund të jetë një sistem vadiës për zgjedhjet e ardhshme.

Ai shtiret sikur po më bind dhe unë shtirem sikur e besoj.

Por jam e kënaqur, ndaj çohem, e falënderoj dhe i them se tashmë e kam gjithë materialin që kisha nevojë.

- Nuk ka ndonjë mangësi?

- Sigurisht që ka, por nuk më takon mua ta them se çfarë.

- Ku mund të takohemi pasi të lëmë punën?

I shpjegoj se duhet të marr fëmijët nga shkolla. Besoj se ai e ka parë unazën e trashë të florinjte në dorën time dhe i them:

- Ajo që iku, iku.

- Sigurisht, po a mund të drekojmë bashkë ndonjë ditë?

Pranova. Më gënjeu mendja shumë shpejtë dhe i them vetes: kush e di, ndoshta ka ndonjë gjë tjetër të rëndësishme për të më thënë, ndoshta një sekret shtetëror, apo diçka që do të ndryshojë në politikën e vendit, çka do të bëjë që të më rritet vlera në sytë e kryeredaktorit të gazetës.

Ai shkoi deri tek dera, e kyç dhe kthehet e më puth. Ia ktheva atë puthje, sepse kishte kaluar shumë kohë qëkur e kishim bërë këtë. Ndoshta do të kisha mundur ta doja Jakobin dikur, ndërsa tani është familjar, i martuar me një profesoreshë, edhe unë jam një familjare, e martuar me një trashëgimtar të pasur, por që punon shumë.

Më shkoi ndër mend ta shtyja e t'i thosha se nuk ishim më fëmijë, por po më pëlqente. Jo vetëm që kisha zbuluar një restorant të ri japonez, por po bëja edhe një gabim. Arrita të shkel rregullat dhe nuk më ra qielli mbi kokë! Kishte kohë që nuk isha ndjerë kaq e lumtur.

Nga çasti në çast ndihem më e guximshme, më e lirë. Më në fund bëra diçka që pata ëndërruar që kur isha në shkollë.

U ula në gjunjë, i hapa zinxhirin e pantallonave dhe fillova t'ia marr me gjuhë seksin e tij. Ai kapi kokën time si për të kontrolluar ritmin. E arriti kënaqësinë e tij në më pak se një minutë.

- Ç'mrekulli!

Nuk u përgjigja. E vërteta është që ishte më mirë për mua se për atë, pasi ai pati derdhje të parakohshme.

**P**as mëkatit vjen frika se mos të kapin për krimin e bërë.

Gjatë kthimit për në zyrë bleva pastë dhe furçë dhëmbësh dhe çdo gjysmë ore shkoja në banjë për të parë mos kishte mbetur diku ndonjë shenjë tek goja apo bluza ime e markës *Versace*, gjithë qëndisje, të cilat mund të fshihnin mirë çdo njollë. Vështroja kolegët e zyrës me bisht të syrit, por askujt prej tyre (apo asnjërës nga ato - se gratë kanë një lloj radari të veçantë për detaje të tilla) nuk i kishte rënë gjë në sy.

Përse ndodhi një gjë e tillë? Dukej sikur dikush tjetër më kish sunduar dhe shtyrë drejt asaj situatë mekanike, e cila nuk kishte asgjë erotike.

A thua desha t'i tregoj Jakobit se jam një grua e pavarur, e lirë, e zonjë e vetes? E kisha bërë gjithçka për ta impresionuar atë, apo për t'i ikur asaj çka mikesha ime e quan “ferri”?

Gjithçka do të jetë si më parë. Nuk jam në udhëkryq. E di se ku shkoj dhe shpresoj që, me

kalimin e viteve, do të arrij të bëj që familja ime të ndërrojë drejtim për të mos përfunduar tek mendimi se larja e makinës është diçka e mrekullueshme. Ndryshimet e mëdha kërkojnë kohë dhe këtë unë e kam me tepricë.

Të paktën kështu shpresoj.

U ktheva në shtëpi duke u munduar të mos shpreh gëzim apo trishtim, gjë që tërheq menjëherë vëmendjen e fëmijëve.

- Mama, je disi e çuditshme sot.

Kam dëshirë të them se jam vërtet, sepse bëra diçka që nuk duhej ta kisha bërë, por që gjithsesi nuk ndihem hiç në faj, vetëm se kam frikë mos më zbulojnë.

Im shoq erdhi si gjithmonë, më dha një puthje, më pyeti si e kalova ditën dhe se çfarë kishim për të ngrënë. I dhashë përgjigjet me të cilat ai është mësuar tashmë, sepse nëse nuk ndryshon asgjë nga rutina edhe ai nuk do të dyshonte që sot pasdreke bëra seks oral me një politikan.

Për dijeni, kjo nuk më dha as më të voglën kënaqësi fizike. Ndaj, tashmë kam dëshirë, kam nevojë për burrë, për puthjet e tij, madje me aq forcë sa të ndiej dhimbje dhe kënaqësinë e një trupi përmbi trupit tim.

---

Kur u ngjitëm në dhomën tonë, e kuptova se isha krejt e eksituar, e marrosur për të bërë dashuri me tim shoq. Gjithsesi duhet ecur qetësisht dhe pa teprime, sepse ai mund të dyshojë.

Bëra banjë dhe shtrihem në krah të tij, i heq tabletën nga duart dhe e vendos mbi komodinë. Fillova t'i përkëdhel gjoksin dhe ai shumë shpejt u eksitua. E bëmë ashtu si nuk kishte ndodhur prej kohësh. Kur lëshoja ndonjë klithmë, ai më kërkonte të kontrolloja veten që të mos zgjoheshin fëmijët, por jam vërtet e ngopur me këtë lloj komenti dhe dua që të shpreh gjithçka ndiej.

Pata disa orgazma. O Zot, sa e dua këtë burrë që kam në krah! Kur mbaruam ishim të lodhur e të djersitur, prandaj bëra një banjë tjetër. Ai hyri pas meje dhe bënte shaka duke më afruar kokën e dushit tek seksi. I kërkova të ndalet se isha e lodhur dhe duhet të flemë, por ai arriti të më eksitojë sërish. Teksa fshinim njëri-tjetrin, në një përpjekje për të ndryshuar mënyrën se si i shihja ditët e mia, unë i kërkova të më çonte në një lokal nate. Besoj se në këtë çast ai dyshoi se kishte diçka ndryshe në këtë mes.

- Nesër?

- Nesër nuk mundem se kam kursin e jogës.

- Meqë e hape këtë temë, a mund të bëj një pyetje të drejtpërdrejtë?

Më ndali zemra, ndërsa ai vazhdoi:

- Përse ke zgjedhur pikërisht jogën? Je një grua kaq e qetë, në harmoni me veten dhe që e di shumë mirë se çfarë dëshiron. A nuk të duket se po humbet kohë?

Zemra filloi të më rrahë sërish. Nuk u përgjigja, por u mjaftova me një buzëqeshje dhe i ledhatova fytyrën.



Shtrihem për gjumë, i mbyll sytë dhe bie në mendime para se të fle: ndoshta po kaloj ndonjë krizë tipike për ata që janë të martuar prej vitesh. Do të më kalojë.

Jo të gjithë njerëzit kanë nevojë të ndjehen të lumtur gjithë kohën, madje askush nuk e arrin këtë. Duhet të mësohemi ta pranojmë realitetin siç është.

I dashur depresion, mos m'u afro. Mos u bëj i keq. Shko tek ata që kanë më shumë arsye se unë për t'u parë në pasqyrë duke thënë: "Jetë pa kuptim". Do apo nuk do ti, unë di si të mposht.

Eh, more depresion që po humbet kohë me mua!

**T**akimi me Jakob Konig kaloi ashtu siç e kisha përfytyruar unë. Shkuam tek *La perle du lac*, Perla e Liqenit, një restorant i shtrenjtë buzë liqenit, që mbahej si i mirë, por tashmë është qyteti që e mban atë. Vazhdon të ketë kosto të lartë edhe pse nuk ka ndonjë kuzhinë të mirë. Unë mund ta kisha befasuar me atë restorantin japonez që mësova kohët e fundit, por e di që do të më quante njeri pa shije. Ka njerëz që vlerësojnë më shumë mjedisin dhe dekorin, se sa pjatën që hanë.

Tani e shoh mirë se kam marrë vendimin e duhur. Ai përpiqet të më tregojë se është njohës i mirë i verës, teksa vlerëson, aromat, trashësinë dhe “lotin”, atë shenjën vajore që le vera në anët e gotës. Ndoshta po më tregon se është rritur dhe nuk është më ai djali që kisha njohur në shkollë, se ka nxënë dhe është ngritur në jetë, andaj e njuh botën, verërat, politikën, gratë dhe ish të dashurat.



Ç'budallallëk! Lindim e vdesim duke pirë verë, prandaj dimë të dallojmë kur është e mirë apo kur është e keqe dhe pikë.

Por, deri sa njoha tim shoq, të gjithë burrat që kam takuar dhe që mendonin se janë të edukuar mirë e quanin zgjedhjen e verës si momentin e lavdisë së tyre personale. Të gjithë bëjnë të njëjtën gjë: mprehin vështrimin, i mbajnë erë tapës, shohin etiketën, i thonë kamerierit të hedhë pak verë për provë, pastaj rrotullojnë verën dhe shohin në anë të kundërt të dritës shenjën që ajo lë në anët e gotës, pinë pak dhe e mbajnë në gojë, pastaj e gëlltitin dhe, më në fund, japin shenjë miratimi me kokë.

Pasi e pashë këtë skenë të plotë kaq e kaq herë, vendosa të ndërroj grup shoqëror dhe të takohem me ata që quheshin “nerds”, një grup shoqëror i mbyllur e i përjashtuar nga turma në fakultet. Ndryshe nga ata kontrollorët e verërave, të parashikueshëm dhe artificialë, këta antisocialët ishin të vërtetë dhe nuk bënë asnjë përpjekje për të bërë përshtypje tek dikush. Flisnin për gjëra që nuk i kuptoja. Mendonin për shembull se unë kisha detyrimin që së paku të njihja termin *Intel*, “meqë është i shkruar në të gjithë kompjuterët”, kurse unë as e kisha vënë re këtë.

Kështu pra, “të pashoqërueshmit” më bënë të ndihesha fare injorante, një femër që nuk e tërheq asgjë, ndërkohë që interesoheshin më shumë për piraterinë e internetit se sa për gjoksin apo këmbët e mia. Si përfundim u ktheva tek siguria e kontrollorëve të verës. Dhe kështu deri sa gjeta dikë që nuk muntohej të më impresiononte me shijet e tij të sofistikuara dhe as më bënte të ndihesha budallaqe me bisedat për planetët misteriozë, apo për programet kompjuterike, të cilët i fshijnë gjurmët e faqeve të hapura më parë. Pas disa muajsh dashuri, gjatë të cilëve njohëm të paktën nja 120 fshatra përreth liqenit që lag Gjenevën, ai më kërkoi martesë.

Pranova menjëherë.

E pyeta Jakobin nëse njeh ndonjë diskotekë, pasi ka vite që nuk e frekuentoj jetën e natës në Gjenevë (“jetë nate” është vetëm një mënyrë të shprehuri) dhe se kam dëshirë të dal për të pirë e për të kërcyer. Atij i shkëlqenin sytë.

- Nuk kam kohë për këtë, jam i nderuar me ftesën, pasi jam person publik, i martuar dhe nuk mund të bie në sy me një gazetare. Do të mendonin se shkrimet e tua janë...

- Tendencioze.

- ... po, tendencioze.

Vendosa ta vazhdoj këtë lojë joshjeje që më zbaviste gjithmonë. Çfarë kam për të humbur?

Në fund të fundit tashmë i njoh të gjitha rrugët, kthesat, kurthet dhe objektivat.

I propozova të më fliste më shumë për veten, për jetën e tij private. Tek e fundit nuk jam këtu si gazetare, por thjesht si grua, si një ish e dashur e adoleshencës së tij.

E ngrita zërin tek fjala “grua”.

- Nuk kam jetë private, - m’u përgjigj ai. - Për fat të keq as që mund të kem. Kam zgjedhur një karrierë që më ka shndërruar në robot. Gjithçka që them përgjohet, hetohet, publikohet.

Nuk është krejt kështu, por sinqeriteti i tij më çarmatosi. E kuptova që e njeh terrenin dhe kërkon të dijë se ku po shkel e deri ku mund të shkojë me mua. Sajoi sikur ishte “i palumtur nga martesë”, ashtu sikurse bëjnë të gjithë burrat e pjekur - pasi provojnë verën dhe shpjegojnë deri sa lodhen se sa të fuqishëm janë.

- Dy vitet e fundit u shënuan edhe nga disa kohë gëzimi, kurse pjesa tjetër është tërhiq e mos e këput dhe përpiqu t’u pëlqesh të gjithëve që të rizgjidhesh. Kam qenë i detyruar të heq dorë nga gjithçka që më falte kënaqësi, siç është për shembull edhe që të kërcenim bashkë këtë javë, apo të rrija orë të tëra duke dëgjuar muzikë, të pija cigare ose të bëja diçka që të tjerët e gjykojnë të papërshtatshme.

- Sa shumë i zmadhon gjërat! Askush nuk merret me jetën tënde personale.

- Ndoshta është kthimi i Saturnit. Çdo 29 vjet ky planet kthehet në pikën e nisjes, pra atje ku ka qenë ditën kur ke lindur.

- Kthimi i Saturnit?

Ai e kuptoi se foli më shumë se ç'duhej dhe sugjeroi që ndoshta ishte më mirë të ktheheshim në punë.

Jo. Kthimi i Saturnit për mua tashmë ka ndodhur dhe dua të di se çfarë do të thotë kjo. Atëherë, ai më jep një leksion astrologjie: Saturnit i duhen 29 vite për t'u kthyer në pikën ku ishte në momentin e lindjes sonë. Deri sa kjo të ndodhë, ne mendojmë që gjithçka është e mundur, që ëndrrat do të realizohen dhe muret që na rrethojnë do të bien. Kur Saturni e plotëson ciklin e vet, zhduket romantizmi, zgjedhjet e bëra janë përfundimtare dhe ndryshimet në udhë e sipër bëhen praktikisht të pamundura.

- Nuk jam specialist natyrisht, por them se shansi im i dytë do të vijë kur të jem 58 vjeç, me kthimin e dytë të Saturnit.

Mendova, atëherë, përse më ftoi të hanim drekë nëse Saturni thotë që nuk ka mundësi më për të zgjedhur një tjetër rrugë? Kemi një orë që flasim.

- A je e lumtur?

- Çfarë?

- Vura re diçka në sytë e tu...një trishtim të pashpjegueshëm për një grua kaq të bukur, e martuar mirë dhe me një goxha punë. Ishte sikur të shihja pasqyrimin e syve të mi, pra po e përsëris pyetjen: a je e lumtur?

Në vendin ku jam lindur e jam rritur, ku po rris edhe fëmijët e mi, askush nuk e bën këtë pyetje. Lumturia nuk është një vlerë që mund të matet me saktësi, të debatohet në plebishite dhe të analizohet nga specialistët. Nuk e pyesim tjetrin as për llojin e makinës që ka, aq më tepër për diçka kaq intime dhe të pamundur të përcaktohet.

- Nuk ka nevojë të përgjigjesh, heshtja mjafton.

Jo, heshtja nuk mjafton, ajo nuk është kurrfarë përgjigje dhe reflekton vetëm mëdyshjen, befasinë.

- Unë nuk jam i lumtur, - tha ai. - Kam gjithçka që një burrë mund të ëndërrojë, por i lumtur nuk jam.

A thua të kenë hedhur ndonjë gjë në ujësjellësin e qytetit? Mos vallë duan të shkatërrojnë vendin tim me ndonjë armë kimike që shkakton çoroditje tek të gjithë njerëzit? Si ka mundësi që të gjithë ata me të cilët bisedoj ndiejnë të njëjtën gjë.

Deri atëkohë nuk fola fare, por shpirtrat e ngjashëm kanë një lloj lehtësie për ta njohur

njëri-tjetrin, për t'u afruar e për të shumëfishuar dhimbjen e tyre.

Si nuk kisha arritur ta kuptoja? Përse u fiksova tek ana sipërfaqësore e fjalëve të tij për politikën apo tek vetëkënaqësia me të cilën provonte verën?

Kthimi i Saturnit. Mungesë lumturie. Gjëra që nuk prisja kurrë t'i dëgjoja nga Jakob Konig.

Pikërisht në këtë kohë vështroj orën, është ora 13:55, por un po dashurohem sërish pas tij. Askush, madje as burri im i mrekullueshëm, nuk më ka pyetur në se isha e lumtur. Ndoshta në fëmijëri prindërit apo gjyshërit kanë dashur të dinë në se isha e gëzuar, por vetëm kaq.

- A do të shihemi sërish?

Shoh para meje, dhe tashmë nuk dalloj më ish të dashurin e adoleshencës sime, por një humnerë së cilës i afrohem pa dashur, një humnerë së cilës nuk dua, në asnjë mënyrë, t'i shmangem. Në një fraksion sekonde mendoj se netët pa gjumë do të bëhen më të padurueshme se kurrë, tani që kam një problem konkret: një zemër të pasionuar.

Të gjitha dritat e kuqe "të alarmit" në ndërgjegjen dhe nëndërgjegjen time filluan të ndizen e fiken pa pushim.

Por i them vetes që je veç një budallaqe, sepse çka kërkon ai është që t'i shkosh në shtrat. Nuk i intereson vërtet lumturia jote.

Atëherë, me një gjest gati vetëvrasës, pranova. Kush e di, mos vallë po të shkoj me dikë që vetëm sa më ka prekur gjoksin në adoleshencë do t'i bënte mirë edhe martesës sime, sikurse ndodhi mbrëmë, kur pasi bëra seks gojor paradite, pata orgazëm të shumëfishtë në darkë?

Përpiqem të kthehem edhe një herë tek biseda për Saturnin, por ai kërkoi llogarinë dhe flet në celular ku njoftoi se do të mbërrijë me pesë minuta me vonesë.

- Të lutem, na sill ujë e kafe.

E pyeta se me kë po fliste dhe më tha se ishte e shoqja. Drejtori i një ndërmarrje të madhe farmaceutike kërkon të takohet me të, ndoshta për të investuar ca pará në këtë fazë të fundit të fushatës së tij për në Këshillin e Shtetit. Zgjedhjet janë shumë afër.

Sërish më ra ndër mend që është i martuar, por që është i palumtur dhe se nuk mund të bëjë asgjë nga ato që i pëlqejnë vërtet. Ka thashetheme se ai me të shoqen kanë një martesë të hapur. Duhet ta harroj atë shkëndijë që m'u ndez në orën 13:55 dhe të kuptoj se ai kërkon vetëm të më përdorë.

Kjo nuk më shqetëson, nëse gjërat bëhen ta qarta. Edhe unë kam nevojë të shkoj me dikë.

---

Qëndruam në trotuar para restorantit. Ai vështroi rreth e rrotull, sikur të ishim një çift shumë i dyshimtë. Pasi pa që nuk po na shikonte njeri, ndezi një cigare.

Mos vallë për këtë ruhej, për cigaren?

- Ashtu siç e mban mend ndoshta, unë isha nxënësi më premtues i klasës, pra duhej të tregoja se ishte vërtet kështu sepse, në fund të fundit, të gjithë kemi nevojë për miratim dhe dashuri. Sakrifikoja daljet me shokët dhe kohën e lirë vetëm për të mësuar shumë e për t'iu përgjigjur pritshmërisë së të tjerëve. Mbarova shkëlqyeshëm shkollën e mesme. Po në fakt, pse e ndërpreme lidhjen tonë?

Nëse ai nuk kujtohet, aq më pak unë. Mendoj se në atë kohë të gjithë mundoheshin të joshnin të tjerët e s'mbetej njeri jashtë loje.

- E mbarova fakultetin, u emërova avokat mbrojtës, u njoha me banditë dhe të pafajshëm, me njerëz të poshtër e me të ndershëm. Kjo punë që duhej të ish e përkohshme u bë vendimmarrja ime në jetë: mund të ndihmoj të tjerët. M'u shtua shpejt numri i klientëve dhe bëra emër në qytet. Im atë mendonte se duhej ta lija atë punë



e të filloja një tjetër, pranë një studioje ligjore të një mikut të tij. Por unë ngazëlleshsha nga çdo çështje që fitoja në gjyq. Jep e merr me ligjet, por pengohesha edhe në ligje të vjetruara që nuk zbatoheshin më. Duheshin ndryshuar shumë gjëra në administrimin e qytetit.

Të gjitha këto janë në CV-në e tij zyrtare, por ta dëgjoje nga goja e tij ishte ndryshe.

- Në një moment të caktuar mendova se mund të dilja kandidat për deputet dhe bëmë një fushatë pa fonde ndihmë, sepse im atë ishte kundër kësaj. Por klientët e mi më mbështetën, çka bëri që të zgjidhem me një numër votash dhe të kaloj pragun elektoral.

Hodhi sytë rreth e qark edhe një herë, e fshehu disi prapa cigaren, por meqenëse askush nuk po na vëzhgonte, ai lëshoi një shtëllungë duhani. Sytë i kish të zbrazët e të fokusuar tek e shkuara.

- Kur hyra në politikë, flija vetëm pesë orë në ditë dhe isha plot energji. Tani kam dëshirë të fle tetëmbëdhjetë orë. Mbaroi muaji i mjaltit me vendin që zura në këtë botë. Ka mbetur vetëm nevoja për të qenë i pëlqyeshëm për të tjerët e sidomos për gruan time, e cila lufton si e marrë që unë të kem një të ardhme të ndritur. Për këtë Mariana ka sakrifikuar shumë dhe nuk mund ta zhgënjej.

A ishte po ky burrë që, pesë minuta më parë, më ftoi të dilnim sërish bashkë? Vallë mos po kërkon që thjesht të dalë e të bisedojë me dikë që e kupton, që ndien të njëjtat gjëra si ai?

Kam dhuntinë të fantazoj me një shpejtësi rrufeje dhe po e shihja veten në një shtëpi në Alpe, e mbështjellë me çarçafë mëndafshi.

- Hë pra, kur do takohemi prapë?

- Zgjidhe ti.

Ai caktoi një takim pas dy ditësh, por i thashë se kisha kursin e jogës dhe m'u përgjigj se mund të mungoja. I shpjegova se më duhej një gjë e tillë dhe se i kisha premtuar vetes të jem më e disiplinuar me jogën.

Jakobi sikur e pranoi. Më pëlqen ta pranoj ftesën, veçse nuk duhet të dukem e paduruar apo shumë e gatshme.

Jeta duket se po lezetohet, ndërsa apatisë së dikurshme ia zë vendin frika. Sa mirë është të kesh frikë se mos humbet një mundësi!

I thashë se ishte e pamundur, prandaj më mirë e lemë për të premtën. Ai pranoi, i telefonoi sekretarit të vet dhe i tha ta shënonte të agjendë.

Mbaroi cigaren dhe u përshëndetëm. Nuk e pyeta se përse më tregoi kaq shumë për jetën e tij private, por edhe ai nuk shtoi asgjë tjetër më të rëndësishme se ato që tha kur ishim në restorant.

Desha të besoj se diçka ndryshoi me këtë drekë. Ishte një drekë profesionale si qindra të tjera që kam pasur, me një ushqim që nuk duhet të ishte i pashëndetshëm e me pije që u shtirëm të dy sikur i pimë, por që ishin të paprekura edhe kur na erdhi kafeja. Nuk duhet ulur vigjilenca, pavarësisht gjithë atij inskenimi të shijimit të verës.

Nevoja për të qenë i pëlqyeshëm për të tjerët.  
Kthimi i Saturnit.

Nuk qenkam e vetmja.

**G**azetaria nuk ka aq magji, sikurse mendojnë njerëzit - të intervistosh njerëz të njohur, të kesh ftesa për udhëtime fantastike, të kesh lidhje me pushtetin, me paranë, apo me botën e çuditshme të njerëzve të shtresave të ulëta.

Në fakt, pjesën më të madhe të kohës e kalojmë në vendet e punës, në ato zyrat e mëdha ndarë me kompensata, ashtu të ngjitur pas telefonit. Privatësia është vetëm për shefat, me ato zyrat rrethuar me xhama e me grila që i mbyllin kur duan vetë. Madje edhe kur e bëjnë këtë, ata e dinë se ç'po ndodh jashtë zyrës së tyre, kurse ne nuk i ndjekim dot më buzët e tyre si të peshkut teksa lëvizin.

Gazetaria në Gjenevën me 195 mijë banorë është gjëja më e mërzitshme në botë. I hedh një sy buletinit të lajmeve të ditës, ndonëse e di se çfarë përmban - takime të zyrtarëve të lartë të vendeve të ndryshme me ata të selisë së Kombeve të Bashkuara,

ankesat e përhershme mbi heqjen e sekretit bankar, një kronikë lajmesh që meriton faqen e parë, si për shembull “Obeziteti pengon një burrë të hipë në avion”, “Ujqit kanë ngrënë bagëtinë në periferi të qytetit”, “Gjurmë parahistorike të gjetura në Shën Zhorzh”, ndërsa me shkronja të mëdha kemi: “Pas restaurimit, anija *Gjeneva* kthehet në liqen, e cila duket më e bukur se kurrë”.

Më marrin në telefon nga puna dhe duan të dinë a kam diçka të veçantë nga dreka ime me politikanin. Siç pritej, na kishin parë bashkë.

Jo, u përgjigja, asgjë përveç atyre që janë në CV-në zyrtare. Dreka ishte vetëm për t’u afruar me një “burim”, sikurse i quajmë ne njerëzit që na japin informacione të rëndësishme. (Sa më i gjerë rrjeti i burimeve, aq më mirë dhe aq më i respektuar është gazetari).

Shefi më komunikoi se një tjetër “burim” e garanton që, edhe pse i martuar, Jakob Konig ka një lidhje me gruan e një politikani tjetër. Ndjeva një cimbim në atë qoshe të errët të shpirtit ku ka goditur depresioni, por që nuk e kam pranuar.

Më pyesin edhe nëse mund të afrohem më shumë me të. Nuk janë shumë të interesuar për jetën e tij seksuale, por ai “burimi” mendon se mos ndoshta po i bëjnë shantazh. Një grup i huaj metalurgjik kërkon të mbyllë problemet fiskale në

vendin e vet, por nuk arrin dot deri tek Ministri i Financave. Prandaj u duhet një “e shtyrë”.

Dhe drejtori më shpjegon se deputeti Jakob Konig nuk është shënjestra jonë, por na duhet që të denoncojmë ata që përpiqen të korruptojnë sistemin tonë politik.

- Nuk do të jetë e vështirë. Mjafton t’i thuhet se jemi në anën e tij.

Zvicra është një ndër të paktat vende në botë ku mjafton fjala e dhënë. Në shumicën e vendeve të tjera duhen avokatë, dëshmitarë, dokumente të nënshkruara dhe garanci për procesin, në rast se del sekreti.

- Na duhet vetëm një konfirmim dhe fotografi.

- E pra, m’u dashka të afrohem me të.

- Nuk është e vështirë. Burimet tona na thanë se e kanë caktuar një takim dhe e ka të shënuar në agjendën e tij zyrtare.

Dhe ky na qenka vendi i sekreteve bankare! Gjithë bota di gjithçka.

- Ndiq taktikën e përhershme.

Kjo “taktika e përhershme” përbëhet nga katër pika: 1. Fillo të pyesësh për diçka interesante, për të cilën vetë i intervistuari kërkon të informojë publikun. 2. Lëre të flasë sa më gjatë të jetë e mundur, që ai të mendojë se gazeta do t’i kushtojë shumë hapësirë. 3. Në fund të intervistës, kur ai të

jetë bindur se na ka nën kontroll, bëja atë pyetjen, *e vetmja* që na intereson, duke i lënë të kuptojë që nëse nuk përgjigjet nuk do t'i kushtojmë vendin që kërkon në gazetë, dhe, pra, po humbet kohë.

4. Po u përgjigj në mënyrë të paqartë, riformuloje pyetjen duke ngulur këmbë tek çështja që duam ne. Ai do të thotë se kjo nuk i intereson kujt, por i duhet nxjerrë patjetër një deklaratë. Në 99 për qind të rasteve, i intervistuari bie në kurth.

Kaq mjafton dhe flake tej një pjesë të intervistës, ndërkohë që përdor si material deklaratën e tij, e cila nuk ka të bëjë më me intervistën e dhënë, por me një temë tjetër të rëndësishme, duke përdorur konkluzione gazetareske, burime zyrtare dhe jo zyrtare, madje “burime” anonime, etj.

- Po qe se ai nuk pranon të përgjigjet, sërish i thuaj se jemi në anën e tij. Ti e di vetë si funksionon gazetaria dhe kjo do të merret parasysht...

E di si funksionon. Karriera e gazetarit është e shkurtër, si edhe ajo e atletit. E arrijmë shpejt lavdinë dhe fuqinë dhe, shumë shpejt, i hapim udhë brezit tjetër. Janë të pakët ata që vazhdojnë dhe përparojnë. Të tjerët e shohin si u bie niveli i jetesës, bëhen kritikë shtypi, krijojnë blog, mbajnë leksione, si dhe kalojnë më shumë kohë se sa është e nevojshme duke u munduar të habisin miqtë. Nuk ka periudhë të ndërmjetme.

Unë jam ende në fazën e “profesionistes premtuese”. Po i nxora ato deklarata, është e mundur që edhe vitin tjetër të mos i dëgjoj ato fjalët: “Na duhet të ulim koston, por ti, me talentin dhe emrin e mirë që ke, me siguri që do të gjesh një punë tjetër”.

A thua do të më ngrënë në detyrë? Pra, unë mund të vendos se çfarë do të botohet në faqen e parë: problemi i ujkut që ka shqyer delet, eksodi i bankierëve të huaj drejt Dubait dhe Singaporit, apo mbi mungesën absurde të godinave për t’u dhënë me qira. Sa emocionuese kjo mënyrë për të shtyrë edhe pesë vitet e ardhshëm...

Kthehem në punë, bëj nja dy telefonata të parëndësishme dhe lexoj çfarë ka interesante në portalet e internetit. Përkrah meje, edhe kolegët e mi, ashtu të dëshpëruar, bëjnë të njëjtën gjë për të gjetur ndonjë lajm që të mos ketë rënie shitjesh për gazetën tonë. Disa thonë se janë parë derra të egër në mes të linjës hekurudhore që lidh Gjenevën me Cyrihun. A thua më del ndonjë artikull?

Sigurisht që del. Ashtu si edhe një telefonatë që sapo mora nga një tetëdhjetëvjeçare, e cila u ankua kundër ligjit që ndalon pirjen e duhanit në bare. Ajo thotë se në verë nuk ka problem fare, por në dimër më shumë njerëz po vdesin nga pneumonia se sa nga kanceri i mushkërive, vetëm sepse të



gjithë janë të detyruar të rrinë jashtë në lokale që të tymosin.

Por, çfarë jemi duke bërë këtu, ne të redaksisë së shtypit të shkruar?

E di mirë: e duam shumë punën tonë dhe duam të shpëtojmë botën.

**E** ulur në pozicionin si zambak uji, me temjanin që digjet dhe duke dëgjuar një melodi të pakëndshme që i ngjante asaj të ashensorëve, unë fillova “meditimin”. Ka kohë që më kanë këshilluar ta provoj. Kjo ndodhi kur mendonin se isha “e stresuar”. (Isha vërtet, por është më mirë se kjo mungesë e plotë interesi për jetën që kam tani).

- Mendime të kota mund t’ju turbullojnë, por mos u shqetësoni dhe pranojini mendimet siç ju vijnë. Mos luftoni me to.”

Shkëlqyeshëm, këtë po bëj. I largoj emocionet toksike sikurse: krenaria, zhgënjimi, xhelozia, boshllëku dhe po e mbush këtë hapësirë me modesti, mirënjohje, mirëkuptim, ndërgjegje dhe falje.

Mendoj se po marr më shumë sheqer se ç’duhet dhe kjo nuk bën mirë as për shëndetin, por as edhe për gjendjen shpirtërore.

I lë mënjanë errësirën dhe dëshpërimin dhe thërras forcat e së mirës dhe dritës.

Më kujtohet çdo detaj i drekës me Jakobin.

Këndoj *një matra*<sup>1</sup> me kursantët e tjerë.

E pyes veten nëse ajo që më tha kryeredaktori është e vërtetë. Mos vërtet Jacobi ka tradhtuar të shoqen? A thua t'i jetë nënshtruar shantazhit?

Mësuesja na kërkon të mendojmë sikur na rrethon një armaturë drite.

- Duhet ta jetojmë gjithçka dhe çdo ditë tonën me idenë se kjo armaturë na mbron nga rreziqet, çka bën të mos mendojmë shumë në dyzimin e qenies sonë. Duhet të kërkojmë rrugën e mesme ku nuk ka as gëzim e as vuajtje, por vetëm një paqe të thellë.

Fillova ta kuptoj se përse mungoj shpesh në kurset e jogës. Dyzimi i qenies? Rrugë e mesme? Kjo më tingëllon aq e panatyrshme sa edhe mbajtja e nivelit të kolesterolit tek niveli '70, ashtu siç më thotë doktori që duhet ta bëj.

Imazhi i armaturës më shfaqet për vetëm disa sekonda, pastaj bëhet copë e thërrime për t'ia lënë vendin bindjes se Jakobit i pëlqen gjithçka, çdo grua e bukur që i del përpara. Po mua ç'më duhet vallë?

---

<sup>1</sup> Tingull ose frazë që e përsërit sa herë të duash. Sipas fesë hindu "OM" është mantra në origjinë të krijimit të botës. (Shën. i përkth.)

Ushtrimet vazhdojnë. Ndryshojmë qëndrimin dhe mësuesja këmbëngul, si përherë, që të përpiqemi, të paktën për disa sekonda, “të boshatisim mendjen”.

Boshllëku është gjëja që më tremb më shumë e që më shoqëron gjithmonë. Ah, sikur ta dinte edhe ajo se çfarë po më kërkon...Fundja nuk më takon mua të gjykoj një teknikë që ekziston prej shekujsh.

Po çfarë bëj këtu?

E di, “po heq stresin”.

**Z**gjothem në mesnatë sërish dhe shkoj në dhomën e fëmijëve për të parë nëse çdo gjë është në rregull - është fiksuar, por që të gjithë prindërit e bëjnë herë pas here.

Kthehem në shtrat dhe i ngul sytë në tavan.

Nuk kam fuqi të them se çfarë dua apo nuk dua të bëj. Pse nuk e lë jogën një herë e për gjithmonë? Pse nuk arrij të kontrolloj veten dhe mendja më rri tek Jakobi? Në fund të fundit, në një farë momenti, edhe ai sikur e hodhi fjalën se kërkonte veç dikë për të folur mbi Saturnin dhe zhgënjimet që, herët a vonë, të rriturit përballen.

Nuk duroj dot më. Jeta ime më ngjan me një film që përsërit të njëjtat skena pa fund.

Mora ca leksione psikologjie kur isha në fakultetin e gazetarisë. Në një leksion, një profesor (një njeri interesant në mësim dhe në shtrat), na tha se ka pesë faza nëpër të cilat duhet të kalojë i intervistuari: mbrojtja, ekzaltimi me veten,

vetëbesimi, rrëfimi dhe përpjekja për të saktësuar gjërat.

Në jetën time, kam dalë nga faza e vetëbesimit drejt e tek ajo e rrëfimit. Kam filluar të mendoj gjëra që do të ishte mirë të qëndronin të fshehura.

Si për shembull: botës i ka ardhur fundi.

Jo vetëm botës sime, por edhe e gjithë atyre që më rrethojnë. Kur takohemi me miq, bisedojmë gjithnjë për të njëjtët njerëz e për të njëjtat gjëra. Bisedat duken si të reja, por e gjitha nuk është tjetër veç shpenzim energjie dhe kohe. Përpiqemi të tregojmë se jeta vazhdon të jetë interesante.

Të gjithë përpiqen të kontrollojnë palumturinë e tyre, jo vetëm Jakobi dhe unë, por edhe im shoq. Vetëm se ai nuk shpreh asgjë.

Në fazën e rrezikshme të rrëfimit ku ndodhem unë, këto gjëra fillojnë të duken qartë. Nuk ndihem vetëm. Jam e rrethuar nga njerëz me të njëjtat probleme, por që shtiren sikur jeta vazhdon si më parë. Si edhe unë. Si edhe fqinji im. Si edhe shefi im, apo burri që kam në krah.

Kur arrin një farë moshe, vendosim një maskë sigurie e vetëbesimi. Më pas kjo maskë na ngjitet në fytyrë e nuk shqitet më.

Kur jemi fëmijë, mësojmë që nëse qajmë do të na përkëdhelin dhe nëse jemi të trishtuar do të na ngushëllojnë. Kur nuk arrijmë t'i bindim të tjerët

me buzëqeshjet tona, atëherë do t'i bindim me lotët që derdhim.

Por tashmë nuk qajmë - përveçse në banjë e kur nuk na dëgjon njeri - as edhe nuk buzëqeshim - vetëm për fëmijët tanë. Nuk i tregojmë ndjenjat tona, sepse njerëzit mund të na gjykojnë si të dobët e mund të përfitojnë nga kjo.

Ilaçi më i mirë është gjumi.

Në ditën e caktuar takova Jakobin. Këtë herë jam unë që e zgjedh vendin dhe përfunduar tek Parku “Eaux- Vives, “Ujërat që rrjedhin”, aq i bukur e i lënë si mënjane, ku ndodhet edhe një tjetër restorant i keq që e mban gjallë qyteti vetë.

Kam ngrënë një herë atje me një korrespondent të gazetës *Financial Times*. Kërkuam Martini dhe kamerieri na shërbeu Cinzano.

Këtë herë, nuk ka gjë për drekë, vetëm sanduiç në natyrë, ku ai mund të pijë cigare i qetë, pasi kemi një pamje të shkëlqyer për gjithë çka na rrethon. Mund të shohim edhe se kush hyn e kush del. Vendosa të jem e ndershme: pas pyetjeve të zakonshme, (si puna, koha, apo si ishte ai lokali se dua të shkoj sonte) e pyeta nëse i kanë bërë ndonjë shantazh apo jo për shkak, le të themi, të një lidhjeje jashtëmartesore.

Ai nuk u befasua. Vetëm se më pyeti nëse po fliste me një gazetar apo me një mikeshë.



Për momentin me një gazetare. Po qe se ma pohon, do t'i jap fjalën se gazeta ime do ta mbështesë. Nuk do të botojmë asgjë nga jeta e tij private, por do të hidhemi mbi shantazhuesit.

- Po, pata një rast me gruan e një miku, të cilën, për shkak të punës që ti bën, duhet ta njohësh. Ishte ai vetë që e nxiti, pasi të dy ishin të lodhur nga martesë. E kupton se ç'dua të them?

Ishte burri që e shtyu? Jo, jo nuk e marr vesh, por bëj një shenjë miratimi me kokë dhe më vjen ndër mend se çfarë ndodhi tri netë më parë, atëherë kur edhe unë pata atë orgazmën e shumëfishtë.

- Historia vazhdon?

- Humbi interesi. Ime shoqe e di, pasi ka ca gjëra që nuk mund t'i fshehësh. Dikush nga Nigeria na ka fotografuar bashkë dhe bën presion se do t'i shpërndajë fotot, por kjo nuk është lajm për askënd.

- Në Nigeri ndodhet ajo ndërmarrja metalurgjike; po gruaja, a nuk të kërcënoi se do të kërkonte divorcin?

- U zemërua nja dy- tri ditë, por jo më shumë. Ajo ka plane të mëdha për martesën tonë dhe mendoj se lumturia nuk është pjesë e tyre. Shprehu pak xhelozë vetëm sa për t'i dhënë rëndësi, megjithatë nuk është aktore e mirë. Pak orë pasi i rrëfeva e çoi mendjen në të tjera gjëra.

Me sa duket, Jakobi jeton në një botë të ndryshme nga imja, ku gratë nuk ndjekan xhelozitë, vetë burrat i nxitin të kenë lidhje! A thua po humbas kohë kot?

- Nuk ka gjë që nuk zgjidhet me kalimin e kohës. Si mendon?

- Varet. Në shumë raste koha mund t'i përkeqësojë problemet. Kjo po ndodh me mua. Ndërkohë, kam ardhur këtu për të intervistuar dhe jo për t'u intervistuar, prandaj nuk kam ndërmend të bëj koment.

Ai vazhdoi:

- Nigerianët nuk e dinë këtë. E kam biseduar me Ministrinë e Financave për t'i futur në kurth e me të gjitha të incizuara, siç bënë ata me mua.

Në atë çast artikullin tim të mundshëm e mori lumi, pikërisht atë që mund të ishte një shans i madh për mua që të ngjitesha në një fushë gjithnjë e më dekadente. S'kam asgjë të re që mund ta tregoj - as shkelje kurore, as shantazh, as korrupsion. Gjithçka është në përputhje me kriteret zvicerane të cilësisë dhe shkëlqimit.

- A i mbarove pyetjet që deshe të më bëje? Mund të kalojmë në ndonjë temë tjetër?

- Po, i mbarova të gjitha.

Në fakt nuk kam më asnjë çështje për të diskutuar.

- Më duket se ke lënë pa më pyetur se përse kërkova që të takohemi sërish. Ja, ngaqë desha të di nëse je e lumtur. Mendoj se jam i interesuar për ty si grua. Nuk jemi më adoleshentë. E pranoj se mbeta i befasuar me sjelljen tënde në zyrën time dhe u kënaqa me gojën tënde, ndonëse ky nuk është motivi kryesor se përse jemi këtu, për më tepër që ajo që ndodhi nuk bëhet në një vend publik. Hë pra, a nuk do që ta dish se përse kërkova të takohemi edhe një herë?

Kutia magjike që mbante brenda atë pyetjen për lumturinë time, atë pyetje që më kapi të papërgatitur, po hedh dritë në qoshe të tjera të errëta. Vërtet ai nuk e di që, për këto gjëra, nuk duhet pyetur?

- Veç nëse ti pranon të më tregosh - iu përgjigja për ta provokuar e për t'ia dërmuar atë pamjen e tij prepotente, që mua më bënte kaq të pasigurt. Ndërkaq shtoj: - Duket qartë që synon të më hedhësh në shtrat, por nuk do të jesh i pari që do të dëgjosh një "jo".

Ai tundi kokën. Shtirem sikur jam në qejf dhe e hedh fjalën tek valët në liqenin normalisht të qetë, të cilin e kemi përballë. I ngulëm sytë mbi të, sikur të ishte gjëja më interesante në botë.

Papritur ai arriti të gjejë fjalët e duhura:

- Sikurse do ta kesh vënë re, unë të pyeta nëse je e lumtur, sepse m'u duke njësoj si unë. Të ngjashmit

tërhiqen nga njëri-tjetri. Ndoshta ti nuk ke parë të njëjtën gjë tek unë, por nuk ka rëndësi. Ndoshta je e lodhur nga nervat, e bindur se nuk janë probleme ato të tuat, ndërsa e di mirë që janë të tilla dhe po të thithin energjitë.

Edhe unë kisha menduar të njëjtën gjë gjatë kësaj dreke: shpirtrat e humbur e dallojnë dhe e tërheqin njëri-tjetrin, duke i trembur të gjallët.

- Ndieja të njëjtën gjë, - vazhdoi, - me dallimin që ndoshta problemet e mia janë më konkrete. Gjithsesi, e urreja veten që nuk kisha arritur ta zgjidh këtë apo atë gjë, në një kohë që varem nga miratimi i këtij apo atij, gjë që bëri të ndihem pa vlerë. Mendova të kërkoj ndihmë mjekësore, por ime shoqe ishte kundër. Ajo thoshte se, po të zbulohet një gjë e tillë, do të më shkatërrohej karriera. I dhashë të drejtë.

Pra, ky burrë i bisedon këto gjëra me të shoqen. Ndoshta sonte në darkë edhe unë do të flas me tim shoq. Në vend që të shkojmë në ndonjë bar, mund të ulem me të dhe t'i tregoj gjithçka. Si do të reagonte vallë?

- Sigurisht që kam bërë shumë gabime. Tani përpiqem ta shoh botën në një tjetër mënyrë, por nuk po funksionon. Kur shoh njerëz si ti, dhe më beso që kam takuar shumë në të njëjtën situatë, përpiqem të kuptoj se si përballen me problemin.

Më shikon, kam nevojë për ndihmë dhe kjo është e vetmja mënyrë për ta pasur.

Kjo na qenka. Jo seks, jo aventurë e madhe, e cila do të ndriçonte si diell Gjenevën gri. Është fjala për një terapi ndihmëse, ashtu siç bëjnë alkoolikët apo të droguarit mes tyre.

U ngrita më këmbë.

Duke e parë në sy i them se isha shumë e lumtur dhe se ai duhet të gjente ndonjë psikiatër. Gruaja e tij nuk mund t'ia kontrollonte kështu jetën, madje në çdo aspekt. Për më tepër, askush nuk do ta merrte vesh, sepse mjeku ruan sekretin mjekësor. I tregova se kam një shoqe që u shërua mbasi filloi të marrë ilaçe. Mos vallë do që ta kalojë jetën që i ka mbetur duke luftuar me fantazmën e depresionit, vetëm e vetëm që të votohet sërish? Këtë dëshiron për të ardhmen e tij?

Ai vështroi rreth e rrotull, se mos më kishte dëgjuar ndokush. E kisha bërë timen dhe e dija se ishim fare vetëm - me përjashtim të një grupi trafikantësh, atje në pjesën e parkut pas restorantit. Por ata nuk kanë asnjë interes të na afrohen.

Nuk arrij të ndalem. Teksa flas kuptoj që jam duke dëgjuar veten dhe kjo po më ndihmon. Theksova se negativizmin e ushqen vetë njeriu, prandaj ai duhet të gjejë diçka që i sjell pak gëzim,

si për shembull të lundrojë, të shkojë në kinema, apo të lexojë.

- Nuk është puna këtu, ti nuk po më kupton. -  
Ai duket sikur e humbi pas reagimit tim.

- Të marr vesh mirë. Nuk ka ditë që të mos na vijjnë mijëra informacione - afishe me adoleshente me makijazh që shtiren si gra dhe na ofrojnë produkte çudibërëse për bukuri të përhershme; lajme të tjera për një çift të moshuar që u ngjit në malin e Everestit, për të festuar përvjetorin e martesës; lajme për pajisje të reja për masazhe; vitrina të tëra të farmacive me produkte për t'u dobësuar; filma me iluzione të kota për jetën; libra që na premtojnë rezultate fantastike; specialistë që na këshillojnë si të bëjmë karrierë apo të gjejmë qetësinë shpirtërore. Të gjitha këto bëjnë që të ndihemi të mplakur dhe të bëjmë një jetë pa aventurë, teksa lëkura thahet, kilogramët nuk i kontrollojmë dot, ndërkohë që jemi të detyruar të ndrydhim emocionet dhe dëshirat, sepse këto nuk hyjnë tek ajo që e quajmë "pjekuri".

Seleksiono informacionet që merr, vendos një filtër tek sytë e tek veshët që të hyjnë vetëm ato që nuk të ulin moralin, se sa për këtë të fundit na mjafton përditshmëria jonë. Mendon se unë nuk jam e kritikuar apo gjykuar në punë? Jam edhe shumë madje. Por kam vendosur t'u vë

veshin vetëm atyre që më nxitin për mirë e që më ndihmojnë të korrigjoj gabimet. Të tjerat zëre se nuk i dëgjova ose i flak tutje.

Erdha këtu në kërkim të një historie të komplikuar që kish brenda shkelje kurore, shantazh dhe korrupsion. Por ti u përballe me gjithçka në mënyrën më të mirë të mundshme. A thua nuk e sheh këtë?

Pa e vrarë mendjen u ula sërish në krah të tij, i marr kokën ndër duar që të mos më ikë dot dhe i jap një puthje të gjatë. Ai hezitoi për një fraksion sekonde, por shpejt ma ktheu.

Menjëherë të gjitha ndjenjat e mija të pafuqisë, dobësisë, pamundësisë dhe pasigurisë i lanë vendin një euforie të madhe. Në çast u bëra e mençur dhe mora kontrollin e situatës, ndërsa guxova të bëj diçka që dikur vetëm e imagjinoja. Po kuturistem në terrene të panjohur dhe dete të rrezikshëm, duke rrënuar piramida e ndërtuar tempuj.

U bëra sërish zonjë e mendimeve dhe veprimeve të mija. Ajo që në mëngjes dukej e pamundur, në darkë bëhet realitet. M'u rikthyen ndjenjat, pra, unë mund të dua diçka që nuk është e imja, madje edhe era nuk më shqetëson më, por më duket sikur më bekon, si një ledhatim i zotit në fytyrën time. Më ka ardhur shpirti në vend.

Duket sikur kanë kaluar njëqind vjet në ato pak çaste që u puthëm. Fytyrat tona largohem ngadalë dhe ai më përkëdhel kokën me ëmbëlsi, ndërsa shohim thellë në sy njëri-tjetrin.

Rikthehemi atje ku ishim më pak se një minutë më parë.

Sa keq!

Tani shtoji kësaj edhe marrëzinë dhe papërgjegjshmërinë e një gjesti, i cili, të paktën në rastin tim, do të përkeqësojë gjërat.

Ndenjëm edhe gjysmë ore bashkë, duke folur për qytetin dhe banorët e tij, sikur të mos kish ndodhur asgjë. Dukeshim shumë të afërt kur mbërritëm në parkun e “Ujërave që rrjedhin” dhe u bëmë njësh në çastin e puthjes, ndërsa tani jemi krejt si dy të huaj që përpiqen të bëjnë një bisedë, deri sa secili të vazhdojë rrugën e tij i pa shqetësuar.

Askush nuk na pa - nuk jemi në një restorant. Martesat tona shpëtuan.

Më shkoi ndër mend të kërkoj ndjesë, por e di që nuk ka nevojë. Në fund të fundit një puthje nuk është aspak diçka e tepruar.



**N**uk mund të them se ndihem fitimtare, por të paktën rimora njëfarë kontrolli mbi veten. Në shtëpi vazhdon gjithçka njësoj: dikur isha keq, tani jam më mirë, por askush nuk më pyet përse.

Do të bëj si Jakob Konig, pra do të flas me tim shoq për gjendjet e çuditshme shpirtërore. Do t'ia besoj atij dhe jam e bindur se do të mund të më ndihmojë.

Ndërkohë, ndihem kaq mirë sot! E pse ta prish ditën me rrëfime për gjëra që nuk e di si do të merren? Jam në luftë me vetveten. Nuk e besoj se kjo që po kaloj ka të bëjë me mungesën e ndonjë elementi kimik në trupin tim, sikurse thuhet në faqet e internetit kur flitet për “trishtimin e detyruar”.

Sot nuk jam e trishtuar. Janë faza normale të jetës. Më kujtohet që kur klasa ime bëri festën e maturës qeshëm për nja dy orë e pastaj, detyrimisht qamë në fund, pasi kjo ishte ndarje përgjithmonë.

Trishtimi vazhdoi disa ditë apo disa javë, madje nuk e kujtoj saktë. Dhe fakti që nuk më kujtohet tregon diçka të rëndësishme, atë që çdo gjë kaloi plotësisht. Të mbushësh 30 vjeç nuk është pak dhe ndoshta nuk isha e përgatitur për këtë.

Im shoq u ngjit lart për të vënë fëmijët në gjumë. Mbusha një gotë verë dhe dola në kopsht.

Vazhdon të fryjë erë, por ne të gjithë e njohim këtë erë që fryn zakonisht tri, gjashtë apo nëntë ditë rresht. Në Francë, e cila është më romantike se Zvicra, e quajnë “Mistral”, sepse kthjellon ditën, ndonëse ftohet koha. Është koha që të na largohen këto re dhe nesër do të kemi një ditë me diell.

Mendja më shkon tek biseda në park dhe tek puthja. Nuk kam asnjë shenjë pendimi. Bëra diçka që nuk e kisha bërë kurrë më parë dhe kështu fillova të shkatërroj muret që më kishin burgosur.

Nuk ka shumë rëndësi se ç mendon Jakob Konig. Nuk mund ta kaloj jetën duke u përpjekur t’u pëlqej të tjerëve.

E mbarova kupën e verës dhe e mbusha sërish, duke shijuar disa orë pas shumë muajsh, ndërkohë që provoj diçka ndryshe nga apatia dhe ndjenja e padobisë.

Im shoq zbriti i veshur si për festë dhe më pyet se sa kohë më duhen për t’u bërë edhe unë gati. E

pata harruar që e kishim lënë të dilnim në ndonjë lokal për të kërcyer këtë mbrëmje.

U ngjita me vrap që të vishem.

Kur zbrita e pashë dadon tonë filipinase që, sapo erdhi, hapi librat mbi tavolinën tonë në sallon. Fëmijët ranë të flenë dhe nuk do ta mundojnë, ndërsa ajo përfiton ndërkaq për të studiuar dhe siç duket nuk e do fare televizorin.

U bëmë gati të dalim. Kisha veshur fustanin tim më të mirë, duke rrezikuar të dukem si gjel deti në një mjedis jo formal. E ç'rëndësi ka? Dua të festoj.

**M**ë doli gjumi nga era që tundte dritaren time. Besoj se im shoq nuk e ka mbyllur mirë. Gjithsesi duhet të çohem e të bëj ritualin e natës, të shkoj tek dhoma e fëmijëve për të parë a janë mirë.

Ndërkaq diçka sikur më pengon. Të jetë efekti i pijes? Fillova të mendoj për valët e liqenit, për retë që u shpërndanë dhe njerëzit që ishin me mua. Nuk e mbaj mend mirë lokalit ku shkuam, ndërkohë që të dy menduam se kishte muzikë të tmerrshme, një ambient të keq, prandaj pasi ndenjëm atje gjysmë ore u kthyem tek tabletat e kompjuterët tanë.

Po gjithë ato që i thashë Jakobit në drekë? Mos duhet të mendoj pak më shumë për veten?

Por kjo dhomë më merr frymën. Burri im i përkryer po fle krah meje dhe me sa duket nuk e dëgjoi zhurmën e erës. Mendoj për Jakobin të shtrirë në krah të bashkëshortes duke i treguar gjithçka ndien (jam e sigurt që nuk do të tregojë

asnjë fjalë për mua), madje i lehtësuar që ka dikë që e ndihmon kur ndihet vetëm. Nuk besoj shumë në mënyrën se si ma përshkroi të shoqen - po të ish e vërtetë, do të ishin ndarë. Në fund të fundit ata nuk kanë fëmijë!

Pyes veten nëse i ka zgjuar edhe ata era Mistral dhe për çfarë mund të bisedojnë në këtë kohë. Ku banojnë? Nuk është e vështirë ta gjej. Në gazetë janë të gjitha këto informacione. A bënë dashuri këtë natë? A ndjeu kënaqësi ai? Po ajo, a vloi nga pasioni?

Sjellja ime ndaj tij është gjithnjë befasuese. Seksi oral, këshillat e matura, puthja në park. Duket sikur nuk kam qenë unë. Çfarë lloj gruaje më sundon kur jam me Jakobin?

Ajo adoleshentja provokuese. Ajo që kish qëndresën e shkëmbit dhe fuqinë e erës dhe turbulloi liqenin Lemman, zakonisht aq i qetë. Është kaq e habitshme që, kur takojmë shokë shkolle, na duket sikur ata kanë mbetur po njësoj - edhe pse ai që ishte i dobët është shëndoshur, ajo më e bukura ka një burrë të shëmtuar, ndërsa ata që ishin tipa të mbyllur, ia kanë mbathur e nuk duken prej vitesh.

Por me Jakobin, të paktën në fillim të takimit tonë, isha unë që munda të kthehem sërish në kohë e të jem ajo vajza e vogël që nuk pyet për pasojat,

sepse është 16 vjeç, ndërkohë që kthimi i Saturnit, i cili do t'i sjellë pjekurinë, është ende larg.

Dua të fle, por nuk mundem. Ndenja nja një orë me mendjen fiksuar tek ai. Më kujtohet fqinji im që lante makinën dhe që e gjykova se bën një “jetë pa kuptim”, duke e zënë kohën me vogëlsira. Nuk ishte i padobishëm dhe ndoshta zbavitej duke bërë lëvizje, duke vështruar gjërat e thjeshta të jetës si të ishin bekim e jo si mallkim.

Ja, kjo më mungon, pra të qetësohem pak e të përfitoj më shumë nga jeta. Nuk mund të rri me mendjen tek Jakobi. E kam zëvendësuar mungesën time të gëzimit me diçka konkrete, me figurën e një burri. Po nuk është çështja këtu. Po të shkoja tek ndonjë psikiatër do të dëgjoja se kam një problem tjetër, se më mungon dëshira për jetën, se kam nivel të ulët serotomine në gjak, e të tjera si këto. Kjo nuk më ndodhi si pasojë e takimit me Jakobin dhe as nuk ikën po të mos e shoh më.

Por nuk mundem ta harroj. Truri më kthen me dhjetëra e me qindra herë çastin e puthjes.

E kuptoj që pavetëdija ime po e transformon një problem imagjinar në real. Kështu ndodh gjithmonë, prandaj shfaqen edhe sëmundjet.

Nuk dua ta shoh kurrë më atë burrë për gjithë jetën. Ma dërgoi dreqi për të destabilizuar anën time të brishtë. Si munda të dashurohesha pas

dikujt që as nuk e njoh? Po kush tha që jam e dashuruar. Kam ca probleme që nga pranvera dhe kaq. Në se deri atëkohë gjërat funksiononin mirë nuk ka arsye të mos funksionojnë sërish po ashtu.

E përsëris çka thashë më parë: është një fazë e jetës e asgjë më tepër.

Nuk mund ta mbaj mendjen po aty dhe të tërheq pas gjëra që nuk më bëjnë mirë. A nuk ia thashë edhe atij këtë këshillë?

Duhet të jem e vendosur dhe të pres deri sa të kalojë kjo krizë. Në të kundërtën, ka rrezik të dashurohem vërtet, të ndiej vazhdimisht atë çka ndjeva për një fraksion sekonde kur drekuam bashkë për herë të parë. Në se ndodh një gjë e tillë, gjërat nuk do të mbeten vetëm brenda meje, por do të përhapen kudo vuajtja dhe dhimbja.

Rrotullohem në shtrat një farë kohe që më duket pafund dhe bie në gjumë, ndërsa kur më zgjoi im shoq m'u duk sikur kish kaluar vetëm një çast. Dita është e kthjellët, qielli është blu dhe era Mistral vazhdon të fryjë.

- Është koha e kafesë së mëngjesit. Lëre, se i rregulloj unë fëmijët.

- Po sikur të këmbejmë rolet të paktën një herë në jetë? Ti shko në kuzhinë dhe unë po i bëj fëmijët gati për në shkollë.

- Mos po më sfidon? Atëherë do të provosh kafe më të mirë se ajo që ke pirë gjithë këto vite.

Nuk është sfidë, por një përpjekje për të ndryshuar diçka. Mos nuk i duket e mirë kafeja ime?

- Dëgjo, është shumë herët për debate. E di që mbrëmë ne të dy pimë pak më shumë se ç'duhet dhe klubet nuk janë më për moshën tonë. Mirë pra, bëji gati fëmijët.

Ai doli përpara se të mbaroja fjalën. Mora celularin dhe verifikova çfarë duhet të bëj në këtë ditë të re.

Pashë listën e detyrave, të cilat duhen plotësuar pikë për pikë. Sa më shumë angazhime në listë, aq



më produktive e quaj ditën time. Ka disa gjëra që më kanë mbetur pa bërë nga dita e djeshme dhe prandaj është mbushur agenda, aq sa me vjen ta flak tej e të bëj një tjetër. Atëkohë e kuptova se nuk kishte ndonjë gjë të rëndësishme në të.

Por ka diçka që nuk e kam shënuar e që nuk mund ta harroj në asnjë mënyrë: të zbuloj se ku banon Jakob Konig dhe të gjej një moment që të kaloj me makinë përpara shtëpisë së tij.

Kur zbrita, tryeza ishte e shtruar dhe e përkryer - sallatë frutash, vaj ulliri, djathëra, bukë e zezë, kos, kumbulla, si dhe një kopje e gazetës ku punoj e vendosur me delikatesë në të majtën time. Im shoq ka kohë që nuk e lexon më shtypin e shkruar se tani shikon *Ipad*-in. Djali im i madh pyet se çfarë do të thotë “shantazh”. Nuk e kuptoja se përse kërkon ta dijë deri sa sytë më vajtën tek titulli kryesor i gazetës. Aty është një fotografi e madhe e Jakobit, një nga ato që ai vetë ia ka çuar shtypit, ashtu me një pamje të menduar. Poshtë fotos edhe titulli: “Deputeti denoncon përpjekjen për shantazh”.

Nuk e kisha shkruar unë, madje isha rrugës për në punë kur shefi më telefonoi për të më thënë se duhet ta anuloj takimin, pasi gazeta kishte marrë një komunikatë të Ministrisë së Financave dhe po punonin me të. I thashë se takimin e kisha bërë, se kishte qenë më i shkurtër nga sa e kisha menduar

dhe që nuk m'u desh të përdorja “formulën e zakonshme”. Në atë kohë më nisën për në një lagje afër (të cilën e quajnë qytezë dhe e kanë bërë me prefekturë), pasi kishte një protestë, për shkak se një dyqan ushqimesh kishte shitur artikuj të skaduar. E dëgjova të zotin e dyqanit, fqinjët dhe miqtë e tyre dhe jam e bindur se kjo çështje është më me interes për publikun e gjerë, se sa fakti që një politikan denoncon çfarëdo qoftë. Megjithatë, shkrimi im ishte në faqen e parë, por jo në vend të dukshëm: “Ushqimorja gjobitet. Nuk ka raporte për viktime të helmuara”.

Ajo fotografia e Jakobit, në mes të tavolinës së mëngjesit, më shqetësoi thellë. I thashë tim shoqi se në darkë desha të bisedojmë diçka.

- I lemë fëmijët me nënën time dhe darkojmë të dy jashtë, - m'u përgjigj. - Edhe unë kam nevojë të kaloj kohë me ty, por vetëm për vetëm, pa atë muzikën e tmerrshme që nuk e marr vesh se si ka sukses.

**I**shte një mëngjes pranvere.

Po rrija në një qoshe të oborrit, një vend ku zakonisht nuk shkonte njeri. Vështroja tullat e mureve së shkollës. E ndieja se diçka nuk shkonte tek unë.

Fëmijët e tjerë më quanin “mendjemadhe” dhe unë as që përpiqesha ta hidhja poshtë këtë. Përkundrazi, i kërkoja nënës sime që të më blinte rroba të shtrenjta dhe të më shpinte në shkollë me makinën e saj luksoze.

Ja, kështu deri atë ditë aty në oborr, kur kuptova se isha e vetmuar dhe ndoshta kështu do të mbetesh për gjithë jetën. Ndonëse isha vetëm tetë vjeç, më dukej vonë për të ndryshuar dhe për t’u thënë të tjerëve se isha si ata.

---

Ishte verë.

Isha në shkollën e mesme dhe shokët e klasës gjenin gjithnjë një mënyrë për të më ngacmuar, edhe pse unë përpiqesha të rrija sa më larg. Vajzat e tjera vdisnin nga zilia, por nuk e bënë veten - përkundrazi mundoheshin të bëheshin shoqe me mua dhe të më rrinin sa më afër për të mbledhur çka unë e lija pas.

Në të vërtetë unë nuk pranoja asgjë, sepse e dija që, nëse dikush do të arrinte të hynte në botën time, aty nuk do të gjente asgjë interesante. Është më mirë të ruash një pamje misterioze dhe t'u tregosh të tjerëve për mundësi që ata kurrë nuk do të arrinin t'i kishin.

Tek kthehesha për në shtëpi, pashë disa kërpudha që ishin rritur nga shiu që kishte rënë. Ishin atje, të paprekura, sepse të gjithë e dinin që ishin të helmatisura. Në një çast të vetëm më shkoi mendja t'i haja. Nuk kisha as ndonjë dëshpërim dhe as ndonjë gëzim të veçantë, por doja vetëm që të tërhiqja vëmendjen e prindërve të mi.

Nuk i preka fare kërpudhat.

---

Sot është dita e parë e vjeshtës, stina më e bukur e vitit. Së shpejti gjethet do të ndërrojnë ngjyrë dhe do të jenë të larmishme nga njëra-tjetra. Gjatë rrugës për tek stacioni vendosa të kaloj nëpër një udhë ku nuk kaloja kurrë.

U ndala para shkollës ku kam mësuar. Muret dhe tullat janë po ato. Asgjë nuk ka ndryshuar, përveç faktit që unë nuk jam më vetëm. Bart me vete kujtimet e dy burrave, njërit që nuk do ta kem kurrë dhe tjetrit, me të cilin do të darkoj këtë mbrëmje në një vend të bukur, të veçantë e të zgjedhur me kujdes.

Një zog çau qiellin duke luajtur me erën. Shkon nga një anë në tjetrën, ngjitet e zbret, sikur lëvizjet e tij të kishin një farë logjike që unë nuk e marr vesh. Ndoshta logjika e tij e vetme është veç të argëtohet.

---

Unë nuk jam zog. Nuk do të mund ta kaloja jetën vetëm duke luajtur, edhe pse kam shumë miq me më pak pará se ne, të cilët bëjnë njërin udhëtim pas tjetrit dhe hanë nga restoranti në restorant. Edhe

unë u përpoqa ta bëj këtë, por e kam të pamundur. Falë lidhjeve të burrit tim sigurova vendin e punës. Punoj mirë, e mbush kohën, ndërkaq ndihem e dobishme dhe justifikoj jetën time. Një ditë, fëmijët e mi do të jenë krenarë për nënën e tyre dhe shoqet e mia të fëmijërisë do të tërbohen nga zilia më shumë se kurrë, sepse kam arritur të ndërtoj diçka konkrete, ndërkohë që ato iu përkushtuan vetëm shtëpisë, burrit dhe fëmijëve.

Nuk e di a e ndiejnë të gjithë këtë dëshirë për të lënë mbresë tek të tjerët. Unë e ndiej dhe nuk e mohoj, sepse kjo më ka bërë mirë në jetë, më ka shtyrë përpara, por deri aty ku nuk ndërmarr rreziqe të panevojshëm, sigurisht. Deri atëherë sa të mund ta mbaj botën time ashtu siç e kam sot.

Sapo mbërrita në gazetë rrëmoja në arkivin dixhital të qeverisë. Brenda minutës e gjeta adresën e Jakob Konig, si dhe informacionet lidhur me të ardhurat, ku ka studiuar, emrin e së shoqes dhe vendin e saj të punës.

**I**m shoq kish zgjedhur një restorant që ndodhet midis punës sime dhe shtëpisë sonë. Kemi ngrënë edhe më parë atje. Më pëlqyen gatimet, pijet dhe ambienti, por gjithnjë mendoj se vaktet e shtëpisë janë më të mirë. Darkoj jashtë vetëm kur e kërkon “jeta shoqërore”, por e shmang sa herë që mundem. Më pëlqen të gatuj, të jem me familjen time, të ndiej se i mbroj dhe jam e mbrojtur njëkohësisht.

Mes gjërave që nuk i bëra atje në listën e detyrave të mëngjesit ishte që “të kaloja me makinë përpara shtëpisë së Jakob Konig”. Ia dola t’i rezistoj këtij impulsi. Kam aq shumë probleme imagjinare, sa që nuk mund të shtoj edhe probleme reale të një dashurie pa përgjigje.

Ajo çfarë ndjeva, tashmë ka kaluar dhe nuk do të kthehet më, prandaj le të ecim kështu drejt një të ardhmeje të paqes, shpresës dhe begatisë.

- Thonë se ka ndërruar pronar dhe gatimi nuk është më i njëjti, - komentoi im shoq.

Nuk ka rëndësi fare, ushqimi i restorantit mbetet po ai, me shumë gjalpë, pjata të zbukuruara shumë dhe meqë jetojmë në një prej qyteteve më të shtrenjta të botës - një çmim marramendës për diçka që në fakt nuk ia vlen.

Por të ngrënët në restorant është një ritual. Na pret kryekamerieri, i cili na çon tek tavolina jonë e zakonshme (ndonëse ka kohë që nuk kishim ardhur këtu), pastaj na pyet në se duam verën tonë të preferuar (sigurisht që po), si dhe na jep menynë. Unë e lexoj fund e krye dhe zgjedh pjatën e zakonshme, kurse im shoq zgjedh mish qengji të pjekur me thjerrëza. Kryekamerieri vjen të na shpjegojë pjatat e veçanta të ditës që i dëgjuam për edukatë, teksa i thamë dy fjalë për mirësjellje dhe kërkuam gatimet me të cilat jemi mësuar.



Gota e parë e verës, e cila nuk qe e nevojshme të provohej e të analizohej me kujdes, sepse jemi të martuar që prej dhjetë vitesh, na fluturoi teposhtë me shpejtësi përmes bisedave për punën, si dhe ankesave për punëtorin që kontrollon sistemin e ngrohjes në shtëpinë tonë, por që nuk po dukej më.



- Si po ia çon me materialet mbi zgjedhjet e së dielës? - më pyeti im shoq.

- Më caktuan si detyrë një çështje që e kam shumë për zemër dhe më duket interesante: “A mundet që jeta private e një politikanë të gjykohet nga votuesit e tij?” Artikulli është në vijim të atij të djeshmit për shantazhin mbi një deputet nga ata nigerianët. Opinioni publik i intervistuar në përgjithësi shprehet: nuk na intereson fare. Nuk jemi në SHBA dhe krenohemi me këtë.

Folëm edhe për çështje të tjera të kohëve të fundit si: taksa e qarkullimit, e cila u rrit me 38 për qind që nga zgjedhjet e fundit për Këshillin e Shtetit. Edhe për shoferët e Transportit Publik të Gjenevës që janë të lodhur, por të kënaqur me punën e tyre. Pasaj për një grua që u shtyp nga një makinë teksa kalonte nëpër vijat e bardha, si dhe për një tren që pati defekt dhe bllokoi trafikun nja dy orë, apo dhe tema të tjera të ditës.

Mora shpejt një gotë të dytë dhe fillova të pi, ende pa ardhur pjata e parë që e ofron restoranti vetë, ndërkohë që as e pata pyetur tim shoq se si e kishte kaluar ditën. Ai më dëgjoji me interes gjithçka thosha dhe ndoshta pyet veten se përse jemi këtu.

- Sot më dukesh më e gëzuar, - tha teksa erdhi kamerieri me pjatën e parë. Atëherë i rashë në të se

po flisja pa pushim për njëzet minuta rresht. - A ka ndodhur ndonjë gjë e veçantë?

Po të ma kish bërë këtë pyetje në ditën kur qeshë tek Parku i “Ujërave që rrjedhin” do të isha skuqur në fytyrë dhe do të rreshtoja një listë me justifikime. Por jo, dita ime kishte qenë e mërzitshme si gjithmonë, edhe pse përpiqem ta bind veten se jam e rëndësishme për botën.

- Për çfarë deshe që të bisedonim?

Bëhem gati t’i rrëfej gjithçka, ndërsa kthej gotën e tretë të verës. Atë çast vjen kamerieri, i cili më shpëtoi kur po hidhesha në greminë. Këmbyem disa fjalë mirësjellje pa kuptim, duke harxhuar minuta të shtrenjta të jetës sime.

Im shoq kërkoi një tjetër shishe vere. Kamerieri na thotë “ju bëftë mirë” dhe shkoi ta marrë. Ndërkaq unë fillova.

- Ti më ke thënë se kam nevojë për doktor, por jo. I përmbush të gjitha detyrat e mia në shtëpi dhe në punë, por ka disa muaj që ndihem e trishtuar.

- Nuk më është dukur kështu. Sapo ta thashë që m’u duke më e gëzuar.

- Sigurisht. Trishtimi im u bë i zakonshëm dhe askush nuk e vë re më. Jam e lumtur që kam dikë për të folur, por ajo që dua të them nuk ka asgjë të përbashkët me këtë pamje të gëzuar. Nuk arrij të fle si duhet. Më duket vetja egoiste. Përpiqem të

bëj përshtypje të mirë, sikur të isha ende fëmijë. Qaj kur jam në banjë dhe pa arsye. Bëra dashuri me qejf vetëm një herë pas disa muajsh dhe ti e di mirë se kur ndodhi. Mendova se e gjitha kjo do të ish një situatë kalimtare, pasi i mbusha tridhjetë vjeç, por ky nuk është justifikim. E ndiej se po e çoj dëm jetën time dhe se një ditë do të kthej kokën pas e do të pendohem për çka bëra në jetë. Përveç faktit që u martova me ty dhe që bëmë fëmijët tanë të mrekullueshëm.

- Por që kjo nuk qenka më e rëndësishmja?

- Për shumë njerëz e tillë është, por për mua është e pamjaftueshme dhe po bëhet gjithnjë e më keq. Kur i përfundoj punët e ditës, më fillon një marrje në pyetje e pafund në kokën time. Ndiej frikë se mos gjërat ndryshojnë, por kam edhe një dëshirë të madhe për të përjetuar diçka ndryshe. Mendimet përsëriten dhe nuk arrij të kem asgjë nën kontroll. Ti nuk e ke marrë vesh këtë, sepse të zë gjumi. E ndjeve mbrëmë se si era tundte dritaren?

- Jo, por ishin të mbyllura mirë.

- Ja, këtë dua të them, qoftë edhe një erë e lehtë që ka fryrë mijëra herë qëkurse jemi martuar, ma nxjerr gjumin. Të ndiej edhe ty kur lëviz në shtrat e kur flet në gjumë. Mos e merr si personale, të lutem, por më duket sikur jam e rrethuar nga gjëra

që nuk kanë asnjë kuptim. Që ta kesh edhe ti të qartë: i dua fëmijët, të dua ty, e adhuroj punën që bëj, por të gjitha këto bashkë më bëjnë të ndihem edhe më keq, sikur po tregohem e padrejtë me Zotin, me jetën, me ju.

Ai pothuaj nuk e ka prekur pjatën dhe duket sikur ka përpara një të huaj. Gjithsesi, pasi i thashë të gjitha këto ndjeva një paqe të brendshme. Rrëfeva sekretin tim. Vera po e bën efektin e saj. Nuk jam më vetëm. Faleminderit Jakob Konig.

- A mendon se duhet të shkosh tek mjeku?

- Nuk e di, por edhe po të ishte kështu, unë nuk dua në asnjë mënyrë ta bëj këtë.

Duhet të mësohem t'i zgjidh vetë problemet e mia.

- Më duket e vështirë t'i mbash këto emocione për shumë kohë. Faleminderit që m'i besove mua, po përse nuk më ke thënë më parë?

- Sepse tani gjërat janë bërë të padurueshme. Sot kam kujtuar fëmijërinë dhe adoleshencën time. A thua që fara të jetë që atëkohë? Nuk e besoj. Veç në qoftë se më ka gënjyer mendja gjithë këto vite, çka më duket e pamundur. Rrjedh nga një familje normale, mora një edukatë normale dhe bëra një jetë normale. Çfarë ka që nuk shkon tek unë? Nuk të kam treguar asgjë më parë, - i them

përmes lotëve, - sepse mendoja që do të kalonte dhe nuk doja të shqetësoheshe ti.

- Po ti nuk je e çmendur. Për asnjë çast nuk e ke bërë veten. As nuk u dobësove, as nuk ke qenë e irrituar, pra kur e ke kontrollin mbi veten ka edhe rrugëdalje.

Pse e hodhi fjalën tek humbja në peshë?

- Mund t'i kërkoj mjekut të familjes që të na japë një recetë me ilaçe kundër anktheve që të ndihmojnë të flesh. Do t'i them se këtë e dua për vete. Besoj që po arrite të çlodhesh, pak e nga pak do të mundesh t'i sundosh mendimet e tua. Ndoshta duhet të bëjmë më shumë ushtrime fizike. Edhe fëmijëve do t'u pëlqente shumë. Jemi përqendruar vetëm tek puna dhe kjo nuk është gjë e mirë.

Nuk e kam mendjen vetëm tek puna. Ndryshe nga sa mund të mendohet, këto reportazhet idiote më ndihmojnë të zë trurin me punë dhe të shmang mendimet e egra që më mbulojnë, sapo që nuk kam më gjë për të bërë.

- Sidoqoftë kemi nevojë për ushtrime fizike dhe për të dalë në ajër të pastër. Të bëjmë vrap deri sa të mos mundemi më, deri sa të na këputë lodhja. Kush e di, ndoshta duhet të thërras më shpesh miq në shtëpi...

Kjo do të ishte një makth i vërtetë! Të jesh e detyruar të bisedosh, të merresh me njerëzit, të

ruash buzëqeshjen, të dëgjosh mendime për opera apo për trafikun, ndërsa në fund të lash edhe gjithë ato enë.

- Këtë fundjavë shkojmë deri tek parku i Juras. Ka kohë që nuk kemi qenë atje.

- Në këtë fundjavë janë zgjedhjet dhe më duhet t'i ndjek nga afër në redaksi.

Hëngrëm në heshtje. Kamerieri erdhi dy herë për të parë nëse kishim mbaruar, por ne nuk i kishim prekur pjatat. Mbaroi shpejt edhe shishja e dytë e verës. Më duket sikur ai tani po mendon: "Si mund ta ndihmoj gruan time? Çfarë mund të bëj unë që të jetë e lumtur?" Asgjë. Asgjë më shumë nga sa bën. Çdo gjë tjetër, si për shembull të vijë në shtëpi me një kuti çokollatash apo me një tufë lulësh, do të ishte si një mbidozë llastimi dhe do të vdisja nga të përzierat e stomakut.

Ndërkaq arritëm në konkluzionin se ai nuk mund të ngiste makinën nga që kish pirë dhe se duhej të linim makinën tek restoranti për ta marrë të nesërmen. I telefonova vjehrrës dhe i thashë që t'i mbante fëmijët edhe për të fjetur, ndërsa unë do të shkoja në mëngjes herët për t'i marrë e çuar në shkollë.

- Po çfarë konkretisht të mungon në jetë?

- Të lutem, mos ma bëj këtë pyetje sepse përgjigja është: asgjë fare.

Asgjë! Kush do ta besonte se unë kisha probleme serioze për të zgjidhur? Nuk njoh njeri që të jetë duke përjetuar këtë situatë. Edhe një shoqja ime që ishte me depresion prej vitesh po trajtohet me ilaçe. Nuk besoj se kam edhe unë nevojë për to, sepse nuk i kam simptomat që përmendi ajo, për më tepër nuk dua të hyj në terrenin e rrezikshëm të drogave të lejuara. Sa për të tjerët, ata mund të jenë të irrituar, të stresuar, duke qarë për një thyerje zemre. Në këtë rastin e fundit, mund të mendojnë edhe sikur janë me depresion, apo se kanë nevojë për mjek e për ilaçe. Por nuk është kështu; është vetëm një thyerje zemre që ka ekzistuar qysh prej krijimit të botës, qëkurse njeriu zbuloi këtë gjënë misterioze të quajtur Dashuri.

- Nëse nuk pranon të shkosh tek mjeku, pse nuk përpiqesh të lexosh diçka mbi këtë çështje?

- Sigurisht që e kam bërë. Për disa kohë lexoja vetëm site të psikologjisë dhe iu përkushtova me këmbëngulje jogës. A nuk e ke vënë re se librat që marr për të lexuar tani janë të një tjetër shije letrare? Mendove se tani po merrem më shumë me anën shpirtërore?

Jo! Unë po kërkoj një përgjigje, të cilën nuk e gjej dot. Pasi lexova nja dhjetë libra me fjalë të urta, vura re se nuk po më çonin kund. Kishin një farë efekti të çastit, por nuk e kishin më kur mbaroja

librin. Janë fjalë e fraza që përshkruajnë një botë ideale që nuk ekziston as për ata që i kanë krijuar.

- Po tani, këtë mbrëmje a ndihesh më mirë?

- Sigurisht, por nuk është puna aty. Kam nevojë të di në çfarë jam transformuar unë, pra kjo jam dhe nuk është diçka jashtë meje.

E shoh se ai po përpiqet më kot të më ndihmojë, por e ka humbur mendjen po aq sa edhe unë. Këmbëngul tek simptomat ndërkohë që i them se problemi nuk është ky dhe se e gjitha është një simptomë.

- A e ke idenë se ç'është një vrimë e zezë thithëse?

- Jo.

- E pra, kjo është.

Ai më siguroi se do të dal nga kjo gjendje dhe se nuk duhet të gjykoj veten. Nuk duhet të fajësoj veten për këtë. Ai do të jetë përkrah meje.

- Ka dritë në fund të tunelit.

Dua ta besoj, por këmbët më janë ngulur fort tek konkretja.

- Gjithsesi, ti mos u shqetëso se do të vazhdoj të luftoj. Kam luftuar gjithë këta muaj. U kam bërë ballë situatave të ngjashme që tashmë i kam kapërcyer. Një ditë do të zgjohem dhe e gjithë kjo do të jetë vetëm një ëndërr e keqe. Kam besim të plotë për këtë.



Ai kërkoi llogarinë dhe më kapi prej dore,  
ndërsa thirrëm një taksi. Diçka ndryshoi për mirë.  
T'i besosh atij që do, gjithmonë jep rezultate të  
mira.

**P**o Jakob Konig ç'kërkon në dhomën time, në shtratin tim, në makthet e mija? Ndoshta po punoj shumë, pasi vetëm tri ditë na ndajnë nga zgjedhjet vendore, ndërsa ti humbe kohë me mua atje tek parku i liqenit, apo duke biseduar bashkë tek Parku “Ujëra që rrjedhin”.

Nuk mjafton? Ç'kërkon atëherë në ëndrrat dhe makthet e mija? Bëra ato që më sugjerove dhe fola me tim shoq, madje e kuptova mirë se sa shumë më do. Edhe ajo ndjesia se lumturia në jetën time ishte zhbërë më iku ndërsa bëmë dashuri, ashtu si nuk kishim bërë prej kohësh.

Të lutem, largohu nga mendimet e mija! Nesër do të kem një ditë të vështirë. Më duhet të çohem herët në mëngjes, të çoj fëmijët në shkollë, të shkoj në treg, të gjej një vend parkimi për makinën, të gjej ndonjë artikull origjinal mbi diçka aq pak origjinale, sikurse është politika... Më lër rehat Jakob Konig.

Kam një martesë të lumtur. Ti as e di dhe as e merr me mend që po mendoj për ty. Do të doja të kisha pranë sonte dikë që të më rrëfente histori me një fund të lumtur, apo të më këndonte një melodi që të më merrte gjumi, por jo. Mendja më rri vetëm tek ty.

Po e humbas kontrollin. Edhe pse ka një javë që nuk shihemi, ti këmbëngul të jesh i pranishëm tek unë.

Po qe se nuk ikën, do të detyrohem të vij në shtëpinë tënde, të pi një çaj me ty e gruan tënde, të shoh që jeni të lumtur dhe që nuk kam asnjë mundësi; madje që më gënjeve se e gjeje veten tek sytë e mi dhe që me vetëdije të plotë më lëndove me atë puthje, të cilën as nuk ta kërkoja.

Shpresoj të më kuptosh dhe lutem për këtë, sepse as unë vetë nuk e di se ç'po kërkoj.

Çohem dhe shkoj tek kompjuteri që të kërkoj “si të fitosh të dashurin tënd”, por pa dashur kam hapur diçka mbi “depressionin”. Duhet të jem e qartë për çka po ndodh me mua.

Hap në internet një faqe që lejon të bësh një vetëdiagnostikim: “Zbulo nëse ke ndonjë problem psikik”. Vjen më pas një listë me pyetje dhe përgjigja ime për pjesën më të madhe të tyre është “jo”.

Rezultati del se: “Ti po kalon një moment të vështirë, por asgjë që mund të cilësohet si gjendje klinike e një depresioni. Nuk ke nevojë për mjek”.

A nuk të thashë? E dija që nuk jam sëmurë. Me sa duket, po e sajoj gjithçka që të tërheq vëmendje. Apo edhe për të gënjyer veten, për ta bërë jetën time më interesante, meqenëse kam *probleme!* Problemet kërkojnë gjithmonë zgjidhje dhe mund t’u kushtoj orët e mija, ditët e mija, javët e mija për t’i gjetur ato.

Madje mund të jetë një ide e mirë që im shoq t’i kërkojë mjekut të familjes të më ndihmojë të fle. Kush e di, mos është stresi i punës, sidomos në këtë periudhë zgjedhjesh, që më tensionon kështu? Po jetoj duke luftuar që të jem më mirë se të tjerët, si në punë ashtu edhe në jetën private, dhe nuk është e lehtë t’i ekuilibrosh këto të dyja.

Sot është e shtunë, vigjilja e zgjedhjeve. Kam një shok që thotë se e urren fundjavën, sepse bursa nuk punon dhe ai nuk gjen me se të argëtohet.

Im shoq më bindi se duhet të dalim. Ai ma argumentoi këtë me faktin se edhe fëmijët kanë nevojë të shëtisin pak. Nuk mund të rrimë dy ditë pushimi jashtë qytetit, pasi më duhet të jem në terren për zgjedhjet.

Ai më këshilloi të vishja pantallona të ngrohta dhe jam e detyruar të vishem trashë, kryesisht kur shkojmë në Nyon, qytet antik e i lavdishëm, i cili dikur u bë strehë për romakët, kurse tani nuk ka as 20 mijë banorë. I thashë se veshjet sportive janë kur nuk shkon larg shtëpisë, ndërkohë që njerëzit mendojnë se ke dalë për sport, por ai ngul këmbë.

Meqë nuk dua debate, bëj siç më thotë ai. Madje nuk dua të diskutoj me askënd, se kështu ndihem tani. Sa më qetë të rri më mirë jam.

Ndërkohë që unë po shkoj për piknik në një qytet që ndodhet vetëm gjysmë ore me makinë prej këtu, Jakob Konig do të jetë në takime me votuesit, ose duke biseduar me ndihmësit dhe miqtë e tij, i shqetësuar dhe ndoshta disi i stresuar, por edhe i kënaqur, pasi po ndodh diçka në jetën e tij. Sondazhet në Zvicër nuk merren shumë parasysh, sepse këtu vota e fshehtë merret shumë seriozisht, megjithatë duket se ai do të rizgjidhet.

E shoqja, me siguri, nuk vë gjumë në sy, por për arsye krejt të ndryshme nga të miat. Ajo po planifikon se si do të presë miqtë pas daljes së rezultatit zyrtar të zgjedhjeve. Tani në mëngjes duhet të ketë shkuar në pazar tek Rue de Rive, rruga Rivë, ku çdo javë ka tezga me zarzavate, perime dhe mish me bollëk, atje përballë portës së Bankës Julius Baer dhe vitrinave të *Gucci*-it, *Prada*-s, *Armanit*, dhe skifterëve të tjerë të luksit. Më pas, ndoshta, hipën në makinë e shkon në Satinji për të parë dyqane verërash, të cilat janë krenaria e qytetit, duke provuar disa mostra e zgjedhur pastaj verën që do t'u pëlqente njohësve të mirë të saj - siç është edhe burri i saj me sa duket.

Më në fund, ajo do të kthehet e lodhur, por e lumtur. Zyrtarisht Jakobi është ende në fushatë, po pse të mos i bësh gjërat gati që një ditë më parë? O zot, ajo tani e pa që nuk ka djathë aq sa duhet!

Merr makinën dhe kthehet sërish në pazar. Mes dhjetëra lloje djathi zgjedh ata që janë krenaria e rajonit të Vaud-it: djathin *Gruyere* (në tre variantet e tij: i ëmbël, me pak kripë dhe atë më të shtrenjtin që kërkon 9 deri 12 muaj stazhionim), djathin *Tomme Vaudoise* (aq i butë brenda dh që hahet i shkrirë apo siç është) dhe *Eltivaz* (i prodhuar me qumështin e lopëve të Alpeve dhe i bërë në zjarr me dru ku zien ngadalë).

A ia vlen të shkosh në dyqan veshjesh e të blesh diçka të re për një rast të tillë? Më mirë të nxjerrë nga dollapi ato të markës Moschino që bleu në Milano, kur shoqëroi të shoqin për një konferencë mbi ligjet e punës.

Po Jakobi, si të jetë vallë?

Kohë pas kohe i telefonon së shoqes nëse duhet të thotë këtë apo atë gjë, nëse është më mirë për takimet në filan rrugë apo në filan lagje, nëse *Tribuna e Gjenevës* ka botuar ose jo diçka të re në sitin e saj. Ka besim tek ajo dhe tek këshillat e saj, ndërsa çlirohet kështu edhe nga tensioni i takimeve të sotme, si dhe pyet për strategjinë që hartuan bashkë dhe se ku duhet të shkojë paskëtaj. Ashtu sikurse la të kuptohet gjatë bisedës sonë në park, ai vazhdon të mbetet në politikë për të mos e zhgënjyer të shoqen. Meqë urren gjithçka po bën, dashuria i jep një tjetër shtysë përpjekjeve të tij.

Në se vazhdon karrierën, ndoshta një ditë do të bëhet President i Republikës. Kjo në Zvicër nuk do të thotë ndonjë gjë e madhe, sepse Presidentët ndërrohen çdo vit dhe të gjithë e dimë mirë që ata zgjidhen nga Këshilli Federal. Megjithatë, kush nuk do të donte të thoshte një ditë se “i shoqi ka qenë President i Konfederatës Helvetike, e njohur botërisht si Zvicër”?

Një gjë e tillë do t'i kishte hapur dyer, do të kishte sjellë ftesa për pjesëmarrje në konferenca në vende të ndryshme të botës, madje ndonjë kompani e madhe do ta ftonte për të qenë anëtare e Këshillit Administrativ të ndërmarrjes. E ardhmja e çiftit Konig ishte e shkëlqyer, kurse unë, tamam në këtë moment, kam përballë rrugën dhe perspektivën e një pikniku, madje e veshur me një kostum sportiv të shëmtuar.



Gjēja e parë që bëmë ishte vizita në Muzeun Roman dhe më pas u ngjitëm në një kodër të vogël për të parë rrënojat. Fëmijët po luanin. Tani që im shoq di gjithçka, sikur ndihem e lehtësuar dhe nuk kam nevojë të shtirem gjithë kohën.

- A bëjmë një vrap në breg të liqenit?

- Po fëmijët?

- Mos u shqetëso. Janë aq të edukuar sa po t'u kërkojmë të rrinë në vend e të na presin, ata të rrinë urtë.

Zbritëm deri në breg të liqenit Lemman, të cilin të gjithë të huajt e quajnë liqeni i Gjenezës. Ai u bleu akullore fëmijëve dhe u kërkoi të ulen në një stol e të na presin, pasi mamaja e babai do të bëjnë vrap. I madhi u ankua që nuk e ka me vete *iPad*-in, por im shoq shkoi te makina dhe ia solli atë aparat të mallkuar. Që nga ky moment, ekrani kthehet në dadon më të mirë të mundshme dhe fëmijët nuk do të lëvizin deri sa të kenë vrapur një

katër terroristë në një lojë, e cila duket sikur është bërë për të rriturit.



Filluam vrapin. Në njërën anë është parku dhe në anën tjetër janë pulëbardhat dhe varkat që shfrytëzojnë Mistralin. Këtë radhë, era nuk fryu tri, as gjashtë, por nëntë ditë rresht dhe do të largohet kushedi se kur, duke marrë me vete kohën e mirë dhe qiellin blu. Vrapuam rreth pistës për një çerek ore. E kemi lënë pas Nyon-in dhe është mirë të kthehem.

Kisha kohë pa bërë ushtrime fizike. Kur u bënë 20 minuta që vraponim u ndala se nuk kisha më fuqi dhe desha ta bëj pjesën tjetër me ecje.

- Sigurisht që mundesh, - ngul këmbë im shoq që erdhi vrap duke mos humbur ritmin. - Mos e bëj këtë, por vazhdo deri në fund.

U përkula para me duart mbi gjunjë, ndërsa zemra më rrihte sikur do të dilte nga vendi, si rezultat i netëve pa gjumë. Ai nuk pushon së vrapuari rreth meje.

- Jepi, se mundesh! Ky është problemi: të ndalesh. Bëje për mua, për fëmijët, se nuk është thjesht ushtrim fizik, por edhe për të ditur se ka

një vijë mbërritjeje, ndaj nuk duhet të ndërpritet në mes.

A thua ta ketë fjalë për trishtimin që më ndjek?

Ai m'u afrua dhe më kapi nga duart, duke më tundur lehtë. Jam e lodhur për të vrapuar, por ndihem edhe më e lodhur për të rezistuar. Bëj siç më thotë ai. Vazhdojmë të vrapojmë të dy bashkë në ato dhjetë minuta që kanë mbetur.

Kaluam përpara posterave të kandidatëve për Këshillin e Shtetit, të cilët nuk i pashë në fillim. Mes të tjerëve ishte edhe Jakob Konig, duke u buzëqeshur kamerave.

E rrita shpejtësinë. Im shoq u habit dhe nxitoi pas meje. E përshkuam distancën për shtatë - në vend të dhjetë minutave. Fëmijët nuk kishin lëvizur nga vendi. Me gjithë peizazhin e bukur përreth, malet, pulëbardhat dhe Alpet në horizont, ata i kanë mbërthyer sytë tek ekrani i vogël i atij aparati grabitës shpitrash.

Im shoq u nis drejt tyre, por unë e kalova. Ai më shihte me habi, por njëherazi edhe i lumtur. Ndoshta i shkon mendja se zunë vend fjalët që më tha, të cilat e mbushën pastaj trupin tim me endorfinën e nevojshme që na përhapet në gjak sa herë që bëjmë aktivitet fizik disi më intensiv, sikurse është vrapim apo një orgazëm. Karakteristikat kryesore të këtij hormoni janë përmirësimi i humorit, i sistemit

imun, shmang plakjen e parakohshme, ndërkohë që nxit mbi të gjitha ndjenjën e euforisë dhe kënaqësisë.

Por nuk është se endorfina po bën efektin e saj mbi mua. Ajo veç më dha fuqi shtesë për të ecur përpara e për të vrapuar, deri sa të zhdukesh në horizont dhe të lija pas meje gjithçka. Përse pata fëmijë kaq të mrekullueshëm? Përse u njoha dhe u dashurova me tim shoq? A do të isha sot një grua e lirë sikur ai të mos kishte hyrë në jetën time?

Jam e çmendur. Duhej të vrapoj ende deri tek një çmendinë këtu afër, sepse këto nuk janë gjëra që duhen shkuar ndër mend. Por unë vazhdoj t'i mendoj.

Vrapova edhe disa minuta dhe u ktheva. Në mes të rrugës u tmerrova nga frika se mos dëshira ime për liri bëhej realitet dhe në kthim nuk do të gjeja më askënd në parkun e Nyon-it.

Por ata ishin atje, duke buzëqeshur për mbërritjen e nënës dhe gruas së dashur. I përqafova të tre. Jam mbushur me djersë dhe më duket sikur trupi e mendja ime janë të ndotur, megjithatë i shtrëngova fort në kraharor.

Kështu, pavarësisht se çfarë ndiej, apo më mirë, pavarësisht se çfarë nuk ndiej.

**T**i nuk e zgjedh jetën tënde; është ajo që të zgjedh. Nëse ato që të ka rezervuar janë gëzime apo trishtime, kjo nuk varet nga dëshira jote. Të mbetet vetëm të pranosh dhe të ecësh përpara.

Nuk jemi ne që e zgjedhim jetën tonë, por e kemi në dorë se çfarë të bëjmë me gëzimet dhe trishtimet që ajo na fal.

Të dielën pasdite shkova në selinë e partisë, si detyrim profesional (arrita ta bind shefin dhe tani mundohem të bind veten). Festa filloi në 17:45. Ndryshe nga sa mendova në fantazinë time të sëmurë, asnjë nga kandidatët nuk do të japë pritje. Pra edhe këtë herë nuk do të shoh shtëpinë e Jakob dhe Mariana Konig.

Sapo mbërrij marr informacionet e para se kanë votuar 45 për qind e votuesve, çka është një rekord. E para kish dalë një grua dhe Jakobi zuri me dinjitet vendin e tretë në listë, gjë që i jep të drejtën të bëjë pjesë në qeveri, po që se e propozon partia e tij.

Salla është zbukuruar me tullumbace të verdha e të gjelbra, njerëzit kanë filluar të pinë dhe disa më japin shenjën e fitores, me shpresë se unë do të shkruaj për ta në gazetën e nesërme. Por fotografët nuk kanë ardhur ende, pasi është e diel dhe dita është kaq e bukur.

Jakobi më vuri re që larg dhe i hodhi sytë në anën tjetër, me shpresë se mos gjente dikë për të biseduar, por e marr me mend se sa pa interes do të jenë.

Më duhet të bëj punën time apo, më mirë, të them të bëj sikur. Nxjerr magnetofonin, një bllok shënimesh dhe një stilolaps. Endem nga një qoshe në tjetrën duke mbledhur deklarata të tipit: “tani mund të miratojmë dekretin mbi emigracionin”, “zgjedhësit do ta kuptojnë se kanë bërë zgjedhjen e gabuar herën që shkoi, prandaj më zgjodhën mua tani”.

Fitimtarja e madhe deklaroi se “votat e grave ishin themelore për mua”.

Leman Blu, televizioni lokal montoi një studio në sallën kryesore. Gazetarja e tij politike, ai objekt i errët dëshire i nëntë në dhjetë burrave aty, po bënte pyetje të zgjuara, megjithatë merrte si përgjigje fraza të gatshme e të miratuara nga këshilltarët.

Në një moment, Jakob Konigun e thirrën në skenë dhe unë afrohem ta dëgjoj, por dikush më preu rrugën.

- Ej, jam zonja Konig dhe Jakobi më ka folur shumë për ju.

Çfarë grua! Bionde e gjatë, me sy blu, e veshur me një triko të gjatë elegante të zezë dhe një shall të kuq të markës Hermes. Meqë ra fjala, kjo ishte e vetmja markë e madhe që vura re. Të tjerat duhet të jenë bërë me porosi tek ndonjë stilist i njohur në Paris, por që emri nuk i duhet thënë se mos porositin të tjerat.

Unë e përshëndeta duke u munduar të ruaj pamjen e të habiturës.

- Të ka folur Jakobi për mua? E intervistova një herë dhe disa ditë më pas drekuam bashkë. Ndonëse gazetarët nuk duhet të japin opinion mbi të intervistuarit e tyre, unë mendoj se burri juaj është i guximshëm për faktin që e bëri të njohur tentativën për shantazh që i bënë.

Mariana, apo zonja Konig, sikurse m'u paraqit vetë, shtirej e interesuar në fjalët e mia. Duhet të dijë më shumë nga sa i shprehin sytë. A thua të ketë komentuar Jakobi takimin tonë në parkun e Ujërave? Duhet ta prek këtë temë?

Intervista në Leman TV filloi, por ajo nuk dukej se kishte i interes ta ndiqte çfarë thoshte i shoqi, pasi duhet ta dinte se ç'do të thoshte. Sigurisht që do t'ia ketë zgjedhur vetë atë këmishën bojë qielli të çelët, kravatën gri, pallton me një prerje të

përkryer, orën që ka në dorë, jo shumë e shtrenjtë - në mënyrë që të mos tërheqë vëmendjen, por as edhe e lirë, që të mos duket sikur nënvlerëson një nga industritë kryesore në vend.

E pyeta nëse kishte ndonjë deklaratë për të dhënë. Ajo m'u përgjigj se, po ta kisha fjalën tek puna e saj si asistente-profesoreshë e filozofisë në Universitetin e Gjenevës, do ta bënte me kënaqësi, por që të deklaronte diçka si gruaja e një politikani të rizgjedhur, kjo i dukej absurditet.

Mendova mos po më provokonte, ndaj vendosa t'ia kthej me të njëjtën monedhë. I them se e adhuroja dinjitetin që tregoi kur mësoi se i shoqi pati një lidhje me gruan e mikut të vet dhe nuk bëri skandal. Madje as atëherë kur kjo histori mbushi faqet e gazetave, në prag të zgjedhjeve.

- Përkundrazi, kur është fjala për seks me mirëkuptim, ku dashuria nuk është pjesë, unë jam në favor të lirisë së marrëdhënieve.

Mos vallë kërkon të lërë të kuptohet diçka? Nuk arrij t'i vështroj drejt ata fanarët blu që janë sytë e saj. Vetëm se vura re që nuk përdor shumë makijazh dhe që as nuk ka nevojë.

- Do të thosha madje, - shtoi ajo, - se ishte ideja ime që të njoftohej gazeta jote nëpërmjet një informatori anonim dhe të tregohej gjithçka para zgjedhjeve. Njerëzit do të harronin pabesinë,



por do të fiksoheshin tek guximi me të cilin ai denonconte korrupsionin, edhe duke marrë parasysh rrezikun e një problemi të mundshëm brenda familjes së vet.

Ajo qeshi me fjalët e saj të fundit dhe theksoi se janë deklarata në OFF, gjë që do të thotë se çka po dëgjoja nuk ishin për botim.

I thashë se sipas rregullave të gazetarisë, njerëzit duhet ta njoftojnë situatën OFF para se të bëjnë deklarata. Gazetari mund të jetë ose të mos jetë dakord. Ta kërkosht këtë pasi ke folur është sikur të duash të kapësh një gjethe që ra në ujë dhe po ecën për ku po e çojnë ujërat. Gjethja nuk mund të vendosë për veten e saj.

- Po ti e pranon, apo jo? Nuk ke as më të voglin interes t'i bësh dëm tim shoqi.

Në më pak se pesë minuta bisedë mes nesh doli në pah një farë armiqësie. Me një lloj mosmiratimi pranova gjithsesi që nuk do të botoja gjë për deklaratimet e saj. Ajo e regjistroi mirë në kujtesën e saj se duhet të paralajmërojë për botimin apo jo. Çdo minutë mëson diçka të re dhe për çdo çast i afrohet më shumë ambicies së vet. Po, ambicies së saj, sepse Jakobi e tha që ishte i palumtur me jetën që bënte.

Ajo nuk po m'i ndante sytë. Vendosa t'i kthehem rolit tim të gazetares dhe e pyeta nëse kishte diçka

për të shtuar. A mos ka përgatitur ndonjë festë të vogël në shtëpi për miqtë më të afërt?

- Sigurisht që jo! Përfytyro sa punë do të kisha dhe, për më tepër, ai u zgjodh tashmë. Festat e darkat bëhen para zgjedhjes në mënyrë që të fitosh vota.

Edhe një herë tjetër m'u duk vetja budallaçkë, por më duhet ta bëj edhe një pyetje.

- Po Jakobi, a është i lumtur?

Ndërkaq e pashë që preka fundin e pusit. Zonja Konig mori një pamje të shkujdesur dhe filloi të flasë ngadalë si të ishte profesoresha që po më jepte mësim.

- Po *sigurisht* që është i lumtur. Mos të shkoj mendja që nuk është?

Këtë grua duhet ta vrasësh e ta çash më katërsh. U ndamë njëherazi, unë për tek një ndihmës që do të më prazantojë me fituesen e parë të zgjedhjeve dhe ajo sepse dikush e thirri për ta përgëzuar. I thashë se pata kënaqësi që e njoha. Do të shtoja se në një tjetër rast do të më pëlqente ta shfrytëzoja pak më tepër - ashtu në Off, sigurisht - lidhur me atë seksin konsensual me gruan e një shoku, pasi nuk pata më kohë. I zgjata kartëvizitën time, në rast se do të donte diçka prej meje, por nuk ma ktheu me të vetën. Para se të largohem, në prani të ndihmësit të fitimares si dhe atij burrit që erdhi

për ta përgëzuar për zgjedhjen e të shoqit, ajo me një lëvizje të shpejtë më kapi prej krahu e më tha:

- E pashë edhe gruan me të cilën drekoi im shoq dhe më erdhi keq për të. Shtiret e fortë, kur në fakt është e brishtë. Hiqet e sigurt, kur në fakt pyet veten se çfarë mendojnë të tjerët për të dhe për punën e saj. Duket se është njeri shumë i vetmuar. Siç e di, e dashur, ne gratë kemi një shqisë të gjashtë, gjithnjë të mprehtë për të zbuluar se kush na e kërcënon marrëdhënien. A nuk është kështu?

- Sigurisht që kështu është, - iu përgjigja pa shprehur asnjë emocion. Ndhmësi për një gjest mospëlqimi. Fituesja po më priste.

- Por ajo nuk ka asnjë shans, - shtoi Mariana.

Ndërkaq më shtriu dorën dhe unë e përshëndeta, teksa e pashë të largohej pa asnjë shpjegim tjetër.

**T**ë hënën gjatë gjithë paradites i rashë celularit personal të Jakobit, por nuk mora përgjigje. Aktivizova bllokimin e numrit tim me idenë që ai ma njeh numrin dhe përpiqem edhe disa herë me numër të fshehur, por sërish pa përgjigje.

I telefonova ndihmësve të tij, të cilët më informuan se ishte shumë i zënë meqë është dita e parë pas zgjedhjeve. Kam nevojë të flas patjetër me të dhe prandaj vazhdova të këmbëngul.

Përdora atëherë një strategji tjetër që nuk e përdor shpesh, të telefonoj nga celulari i një personi të tretë, që nuk është në listën e tij të kontakteve.

Pas dy zileve del Jakobi.

Jam unë dhe dua të takohemi urgjentisht.

Jakobi më përgjigjet me edukatë, duke më thënë se ndoshta sot do të jetë e pamundur, por do të më telefonojë ai një herë tjetër.

- Ky është numri yt i ri?

- Jo, jo, e mora borxh, sepse ti nuk më përgjigjeshe me telefonin tim.

Ai qeshi si të ishim duke folur për gjënë më të këndshme në botë. E marr me mend se ka afër të tjerë njerëz dhe maskohet mirë.

- Dikush na ka bërë një fotografi në park dhe kërkon të më bëjë shantazh, - gënjeva unë. - Do t'i them se fajin e pati ai që më tërhoqi. Zgjedhësit që votuan me idenë se diçka e tillë ka ndodhur vetëm një herë do të zhgënjeheshin shumë. Edhe pse u zgjodhe për në Këshillin e Shtetit, kjo do të sillte humbjen e postit ministror.

- Mojt, si e ke punën ti?

I thashë se isha në rregull dhe mbylla telefonin. Ndërkaq i kërkoja të më çojë mesazh për orën dhe vendin e takimit për nesër.

Jam mirë fare.

E pse të mos jem? Tekefundit kam edhe me se të merrem në këtë jetë të mërzitshme. Edhe netët e mija pa gjumë nuk janë plot mendime të kota e të pakontrolluara, sepse tani e di se çfarë dua. Kam një armike që duhet ta mposht, si dhe një objektiv për të arritur.

Një burrë.

Nuk është dashuri, por edhe sikur të jetë, çka nuk është rasti. Dashuria ime më përket mua dhe jam unë ajo që mund t'ia fal kujtdo që ma ka qejfi,

qoftë edhe sikur të mos jetë e ndërsjellë. Sigurisht që po të ndodhte kjo do të ishte shumë mirë, por edhe nëse nuk ndodh, durim. Nuk do të heq dorë nga gërmimi i këtij pusi ku jam, sepse e di që atje në fund të tij ka ujë, ujë që buron.

I gëzohem kësaj ideje që pata; jam e lirë të dua këdo në këtë botë. Mund ta marr vetë vendimin pa qenë nevoja t'i kërkoj leje askujt. Sa burra mund të jenë pasionuar pas meje dhe nuk kanë marrë përgjigje? Edhe kështu ata prapë më dërgonin dhurata, më përshëndesnin apo skuqeshin para shokëve, por kurrë nuk u armiqësuan me mua.

Tek më shihnin nga larg, ende ruanin në sy atë dritën e një fitoreje të pamundur, por edhe dëshirën që ta kërkonin sa të ishin gjallë.

Nëse ata vepronin kështu, pse të mos e bëj edhe unë këtë? Është interesante të luftosh për një dashuri ku nuk merr përgjigje.

Mund të mos jetë zbavitëse. Mund të lerë shenja të pariparueshme e të pashlyeshme. Por është interesante, sidomos për dikë që, disa vite më parë, pati frikë të rrezikonte dhe filloi të ndiente çaste tmerri përpara mundësisë së ndryshimit të gjërave pa mundur t'i kontrollojë.

Nuk do t'i shtyp më ndjenjat e mia. Kjo sfidë po më shpëton.

---

Para gjashtë muajsh blemë një makinë të re larëse dhe na u desh të bënim disa punime hidraulike, prandaj edhe u detyruam të ndryshonim pllakat e të lyenim muret, por në fund ambienti u bë më i bukur se kuzhina.

Për të shmangur kontrastin iu futëm edhe reformës në kuzhinë, por vumë re që edhe salloni dukej i vjetruar. Përtëritëm sallonin që u bë më i këndshëm se studioja, e cila nuk kish parë riparime që prej dhjetë vitesh.

Iu futëm edhe studios dhe hap pas hapi reforma përfshiu tërë shtëpinë.

Shpresoj që të ndodhë kështu edhe në jetën time, pra që gjërat e vogla të çojnë në transformime të mëdha.

**K**alova disa kohë duke gërmuar në jetën e Marianës, e cila zyrtarisht paraqitet si zonja Konig. Ka lindur në një familje të pasur, aksionarë në shoqërinë më të madhe farmaceutike në botë. Fotografitë e saj në internet e tregojnë gjithmonë elegante, si në aktivitete sportive, ashtu edhe në ato shoqërore. Asnjëherë nuk duket e veshur as më mirë e as më keq nga sa e kërkon rasti. Kurrë nuk do të kishte shkuar me kostum sportiv në Nyon dhe as me fustan Versaçe në një bar plot me të rinj, sikurse bëra unë.

Ndoshta është gruaja që e kanë zili në gjithë Gjenevën e mëgjerë. Edhe pse është trashëgimtare e një pasurie të madhe dhe e martuar me një politikan të ri premtues, ajo ndjek karrierën e saj si asistente-profesoreshë në filozofi. Ka bërë edhe dy studime, madje ai për doktoraturën ishte “Mbi brishtësinë dhe psikozën pas daljes në pension”, i cili u bë pjesë e botimeve të Universitetit të



Gjenevës. Ka botuar edhe dy artikuj në revistën “Takime” krahas Adorno dhe Piaget. Ka sitin e saj në Wikipedia në frëngjisht, ndonëse nuk e përditëson shpesh. Atje cilësohet specialiste edhe për agresionet, konfliktet, ngacmimet në azilet e pleqve në Zvicrën Romane. Duhet të dijë shumë edhe për agoninë dhe ekstazën e qenies njerëzore - njohuri aq të thella, sa që nuk arrin ta trembë as edhe “seksi konsensual” i të shoqit.

Është një stratege e shkëlqyer, madje bëri që edhe një gazetë tradicionale t’u besojë informacioneve anonime, të cilat asnjëherë nuk duhen marrë seriozisht dhe që nuk janë me bollëk në Zvicër. Dyshoj se mos është paraqitur edhe vetë si burim anonim.

Manipulatore: se arriti të transformonte diçka që mund të kishte qenë shkatërrimtare, në një mësim tolerance dhe bashkëfajësie në çift, madje edhe si luftë kundër korrupsionit.

Vizionare: se u tregua inteligjente duke mos u ngutur për të bërë fëmijë. Ka kohë ende për vete dhe mund të ndërtojë çka dëshiron pa u shqetësuar nga të qarat e natës dhe llafet e fqinjëve që thonë se duhet lënë puna e t’u kushtohet më shumë vëmendje fëmijëve. (Pikërisht kështu bëjnë edhe fqinjët e mi.)

Instinkt të shkëlqyer: se nuk më shikon mua si kërcënim, pasi pavarësisht pamjes së jashtme, unë nuk përbëj rrezik për askënd, përveç vetes sime.

Ja kjo është gruaja që dua ta shkatërroj pa pikë mëshire.

Sepse nuk është një e shkretë që ngrihet në pesë të mëngjesit për të shkuar në qendër të qytetit për të punuar, apo që nuk duhet ta shohë pallati, duke vdekur nga frika se mos e zbulon dikush që punon në të zezë. As edhe si një nga gratë e fryra e të martuara me funksionarë të Kombeve të Bashkuara, që jep pritje për t'u treguar të tjerëve sa e lumtur dhe e pasur është, madje edhe në rast se të gjithë e dinë që i shoqi ka një dashnore njëzet vjet më të re se ajo. Madje, as nuk është e dashura e funksionarit të Kombeve të Bashkuara, e cila punon në ato zyra dhe që sado të përpiqet në punë, askush nuk e merr seriozisht për t'i vlerësuar punën, pasi “ka një histori me shefin”.

Nuk është as ajo drejtorja e përgjithshme, e vetmuar dhe e pushtetshme, e cila ka ardhur në Gjenevë për shkak se këtu u vendos selia e Organizatës Botërore të Tregtisë dhe ku të gjithë e marrin shumë seriozisht ngacmimin seksual në punë dhe nuk guxojnë të shkëmbejnë shikimin me askënd. Gjithsesi, natën fikson tavanin e muret e një shtëpie të stërmadhe të marrë me qira dhe

që, herë pas here, kur dëshiron, thërret ndonjë djalosh ta dëfrejë që të harrojë se do ta kalojë çka mbetet nga kjo jetë pa bashkëshort, pa fëmijë, pa të dashur.

Jo, jo, Mariana nuk bën pjesë në asnjë nga këto raste. Ajo është një grua e plotësuar.

**K**am fjetur më mirë, por duhet të takoj Jakobin para fundjavës. Kështu të paktën më premtoi dhe nuk e besoj të ketë kurajën të më dalë nga fjala. M'u duk nervoz kur folëm në telefon të hënën.

Im shoq mendon se e shtuna që kaluam në Nyon më bëri mirë. As që i shkon mendja që pikërisht atë ditë zbulova se çfarë më bënte aq keq: ishte mungesa e pasionit, e aventurës.

Një nga simptomat që kuptova tek vetja ishte një lloj autizmi psikologjik. Bota ime, dikur e gjerë e plot mundësi, po zvogëlohet duke ia lënë vendin nevojës për siguri. Përse? Duhet të jetë një trashëgimi e bartur nga të parët tanë që jetonin në shpella: grupet mbrohen, të vetmuarit janë të dënuar të zhduken.

Ndonëse e dimë që edhe në grup është e pamundur të kontrollosh gjithçka, si, për shembull, rënien e flokëve apo një celulë që tërbohet e kthehet në tumor.

Por ajo siguria e rreme, na bën ta harrojmë një gjë të tillë. Sa më shumë t'i kemi parasysh kufijtë e jetës sonë, aq më mirë është. Edhe sikur të jetë fjala për një kufizim psikologjik, ndërkohë që thellë brenda nesh e dimë se herët a vonë vdekja na vjen pa na pyetur, mirë është të shtiresh sikur ke gjithçka nën kontroll.

Kohët e fundit e kam pasur shpirtin të revoltuar e të trazuar si deti. Bëra një analizë për veten dhe m'u duk sikur po bëja një udhëtim transoqeanik mbi një trap druri në kohë stuhie. A do të mbijetoj? - pyeta veten - teksa nuk ka kthim prapa.

Sigurisht që do të mbijetoj.

Kam kaluar stuhi edhe më parë. Bëra një listë gjërash ku duhet të përqendrohem në çastin që do të ndiej rrezikun se mund të bie sërish në atë vrimën e zezë:

- Të luaj me fëmijët dhe t'u lexoj përralla që shërbejnë si mësim për ata dhe për mua vetë, sepse përrallat nuk kanë moshë.

- Të shoh qiellin.

- Të pi gota me ujë të ftohtë mineral. Duket gjë e thjeshtë fare, por unë ndihem sikur marr forcë kur e bëj këtë.

- Të gatuj. Ja, ky është arti më i plotë e më i bukur. Ai kërkon pesë shqisat tona, madje plus një

- nevojën që të japim më të mirën nga vetja. Kjo është edhe terapia ime e parapëlqyer.

- Të bëj një listë ankesash. Kjo na ishte një goxha zbulim! Sa herë nervozohem për diçka qahem e pastaj e mbaj shënim. Në fund të ditës e kuptoj se jam acaruar më kot.

- Të buzëqesh edhe kur dua të qaj. Kjo është më e vështira nga çdo gjë tjetër në listë, por jemi mësuar më këtë. Budistët thonë se një buzëqeshje e fiksuar në fytyrë, sado e pavërtetë qoftë, në fakt e ndriçon shpirtin.

- Të bëj dy dushe në ditë dhe jo një. E than lëkurën për shkak të gëlqeres në ujin e qytetit, por edhe të bën mirë nga ana tjetër se të shpëlan shpirtin.

Të gjitha këto, gjithsesi, funksionojnë kur e ke objektivin: të bësh për vete një burrë. Jam si një tigër që e ndjekin e nuk ka nga të shkojë. E vetmja gjë që më ka mbetur është të sulmoj me tërbim.

**M**ë në fund e kam një datë: nesër në orën 15:00 tek restoranti i Klubit të Golfit të Kolonisë. Mund të ishte në çdo lloj birrorarie të qytetit, apo në një bar në rrugët që çojnë tek ajo kryesorja, rruga tregtare e qytetit, por ai zgjodhi restorantin në Klubin e Golfit.

Në pikë të pasdites.

Sepse në këtë kohë në restorant nuk ka njerëz dhe mund të kemi më shumë privatësi. Duhet të gjej pastaj edhe një justifikim për shefin tim, por ky nuk është ndonjë problem i madh. Në fund të fundit, e kam bërë një artikull për zgjedhjet, i cili pati jehonë edhe në gazetatat e tjera të vendit.

Ndoshta ai ka menduar për ndonjë vend të fshehtë. Ndoshta një vend disi romantik, mendova unë me atë maninë time për të besuar në gjithçka dua. Vjeshta i ka pikturuar pemët me të gjitha ngjyrat e praruara dhe ndoshta do ta ftoj Jakobin që të bëjmë një shëtitje. Më punon mendja më mirë

kur jam në lëvizje dhe më mirë akoma kur vrapoj, sikurse më ndodhi në Nyon, por nuk e besoj se është e mundur.

Kuak, kuak, kuak.

Në mbrëmje darkuam në shtëpi me djathë të pjekur, atë djathin e shkrirë, mishin e prerë hollë si proshutë dhe si zakonisht patate të pjekura me krem qumështi. Familja ime pyeti nëse kishim ndonjë gjë për të festuar dhe u përgjigja me një po, për faktin e të qenit së bashku e që mund të gëzojmë një darkë të qetë. Pastaj bëra banjën time të dytë për atë ditë dhe e lashë ujin të rridhte si për të shpëlarë tërë ankthin tim. U leva me shumë krem dhe shkova në dhomën e fëmijëve t'u lexoj një përrallë. I gjeta përmbys mbi tabletat e tyre, një mjet që duhej ndaluar për fëmijët nën 15 vjeç.

I urdhërova t'i mbyllin dhe ata m'u bindën pa dëshirë. Ndërkohë mora një libër me tregime dhe e hapa kuturu e fillova të lexoj:

*Në epokën e akujve ngordhnin shumë kafshë për shkak të ngricës. Atëherë derrat qime ashpër vendosën të bëhen grup që të ngrohnin dhe mbronin njëri-tjetrin.*

*Por qimet si gjemba shponin ata që ishin më afër, pikërisht ata që jepnin më shumë ngrohtësi. Në këto kushte vendosën të rrinin sërish të ndarë e larg njëri-tjetrit. Mirëpo kështu disa ngordhën të ngrirë nga të ftohtët.*



*U mbetej të bënin një zgjedhje: ose të zhdukeshin nga faqja e dheut, ose të pranonin çmimin e dhimbjes nga gjembat e atyre që kishin afër.*

*Si të mençur që ishin, ata vendosën të bashkohen në grup. Mësuan të jetojnë me ato plagët e vogla që i bënëin njëri-tjetrit me qimet si gjemba që shpojnë ata që ke afër, sepse, në fund fare, më e rëndësishme është ngrohtësia që ata të japin. Ja, kështu edhe mbijetuan.*

Fëmijët pyesnin se kur do të shohin një derrgjembaç të vërtetë.

- A ka në kopsht zoologjik të tillë?

- Nuk e di.

- Po çfarë është epoka e akujve?

- Një herë e një kohë kur bënte shumë ftohtë.

- Ashtu si në dimër?

- Po, por një dimër që nuk mbaron kurrë.

- Po ata, pse nuk i heqin qimet e forta përpara se të përqafohen?

O Zot! Duhet të kisha zgjedhur një histori tjetër. U fika dritën e dhomës dhe vendosa t'u këndoj diçka tradicionale nga një fshat mes alpeve, duke i ledhatuar të dy. I zuri gjumi shumë shpejt.

Im shoq më solli Valium. Gjithmonë kam refuzuar të pi ilaçe se kam frikë mos bëhem e varur prej tyre, por duhet të jem në formë për nesër.

Piva 10 mg qetësues dhe më zuri një gjumë i thellë e pa ëndrra, që nuk më doli as në mesnatë.

**A**rrita para kohe dhe eca drejt nëpër sallën e madhe që e fsheh disi Klubin e Golfit, për të dalë në kopsht. Shkova deri te pemët në anën tjetër, e vendosur ta shfrytëzoj në maksimum atë pasdite të bukur.

Melankoli. Kjo ishte fjala e parë që të vjen ndër mend në vjeshtë, sepse e di që vera kaloi, ditët shkurtohen vazhdimisht dhe nuk jetojmë në botën e derrave qime-ashpër të epokës së akujve; askush nuk duron asnjë lëndim prej të tjerëve.

Po, në vendet e tjera po shohim që ka njerëz që vdesin për shkak të temperaturave, bllokime rrugësh, madje edhe aeroporte që mbyllen. Oxhaqet janë ndezur, kuvertat e trasha dalin nga dollapët. Megjithatë kjo ndodh vetëm në botën që kemi ndërtuar ne.

Jashtë në natyrë, peizazhi është i mrekullueshëm, pemët dikur aq të ngjashme me njëra-tjetrën fitojnë personalitet dhe i zbukurojnë pyjet me

qindra ngjyra të praruara. Një pjesë e ciklit jetësor kap fundin e vet. Gjithçka çlodhet për ca kohë për t'u gjallëruar në pranverë në formën e luleve.

Nuk ka kohë më të bukur se vjeshta që të fillojmë të harrojmë gjërat që na shqetësojnë. T'i lëmë ato të bien si gjethet në vjeshtë dhe të mendojmë se sërish do të kërcejmë, madje duhet përfituar nga çdo thërrime dielli që ngroh ende, teksa të ngroh shpirtin dhe trupin me rrezet e tij, para se të shkojë të flejë e të shndërrohet në një llambë në qiell.



E dallova nga larg që ai erdhi. Më kërkoi në restorant, në tarracë dhe shkoi tek baristi, i cili i bën shenjë në drejtimin tim. Atëherë Jakobi më pa e ma bëri me dorë. Eca ngadalë drejt sallës së klubit, në mënyrë që ai të vinte re veshjen time, këpucët, trikon e stinës dhe mënyrën e të ecurit. Edhe pse e kam shpirtin copë- copë nuk duhet të humbas ritmin.

Po i zgjidhja fjalët që do të thosha. Po pse dreqin u takuam sërish? Pse ky kontroll i madh i vetes, ndërkohë që e dimë se ka lindur diçka mes nesh. Mos vallë kemi frikë se pengohemi dhe biem, sikurse ka ndodhur shumë herë?

Teksa eci, më duket se po hyj në një tunel që nuk e kam përshkuar kurrë, tamam ai që të çon nga cinizmi tek pasioni, nga ironia tek kapitullimi.

Çfarë mendon ai tek më sheh duke ecur drejt tij?

Kam nevojë të shpjegoj që nuk duhet të trembemi dhe se “nëse e Keqja ekziston, rri e fshehur tek frika brenda nesh”?

Melankoli. Kjo është fjala që tashmë po më transformon në një grua romantike dhe po më rinon në çdo hap që hedh.

Vazhdova të kërkoj fjalët që do të thosha kur ta kisha përballë. E mira është të mos i zgjedhësh, por t’i lësh fjalët të rrjedhin natyrshëm. Ato janë brenda meje. Unë mund të mos i njoh, të mos i pranoj, por ato janë më të fuqishme se nevoja ime për të kontrolluar gjithçka.

Përse të mos i dëgjoj fjalët e mia para se t’ia them atij?

Mos ndoshta nga frika? E çfarë mund të jetë më keq se sa një jetë gri, e trishtuar dhe ku ditët janë të gjitha njësoj? Apo më shumë se ai tmerrri se mos gjithçka merr fund, madje edhe shpirti im dhe mbetem fillikat në këtë botë, ndërkohë që i pata të gjitha për të qenë e lumtur?

Shoh, përkundër diellit, hijet e gjetheve që bien nga pemët. E njëjta gjë është duke ndodhur edhe

brenda meje: në çdo hap që hedh, bie një pengesë, shkatërrohet një mur mbrojtës, një barriera sigurie, ndërsa zemra ime, fshehur pas tyre, fillon të shohë dritën e vjeshtës dhe t'i gëzohet.

Për çfarë do të flasim sot? Për muzikën që dëgjoja në makinë duke ardhur për këtu? Për erën që lëkund pemët? Për kushtet njerëzore, me gjithë kontradiktat e veta, errësirën dhe shpagimin?

Mund të flasim për melankolinë, por ai do të thoshte që është një fjalë e trishtuar. Do t'i thosha se jo, se është nostalgjia, diçka e harruar dhe e dobët, siç jemi të gjithë kur bëjmë sikur nuk e shohim rrugën ku na ka hedhur jeta pa na pyetur, apo kur e mohojmë fatin tonë, sepse ai na çon në drejtim të lumturisë, ndërkohë që ne kërkojmë vetëm sigurinë.

Edhe pak hapa. Shumë barriera të tjera barriera bien, më shumë dritë hyn në zemër. Tashmë nuk më shkon ndër mend të kontrolloj çfarëdo qoftë, por vetëm të përjetoj këtë pasdite që nuk do të përsëritet më. Nuk më duhet ta bind për asgjë. Po qe se nuk e kupton tani, do ta kuptojë më vonë. Është vetëm çështje kohe.

Ndonëse bën ftohtë, do ulemi në verandë, kështu ai edhe mund të pijë cigare. Në fillim do të jetë si në pozicion mbrojtje, duke më pyetur se ç'është ajo foto që na paskan bërë në park.

Por do të bisedojmë mbi mundësinë për të pasur një jetë në ndonjë tjetër planet dhe për praninë e Zotit, të cilën shumë herë e harrojmë për shkak të sjelljes sonë. Do të flasim për besimin dhe për rrugët që janë përcaktuar për ne qysh para se të lindim.

Do të diskutojmë edhe për luftën e përhershme mes shkencës dhe fesë. Do të flasim për dashurinë që shihet gjithmonë si dëshirë dhe kërcënim. Ai do të ngulë këmbë se përcaktimi im për melankolinë nuk është i saktë, por unë do të mjaftohem duke pirë një çaj në heshtje, duke vështuar perëndimin e diellit mbi malet e Juras, e kënaqur që jam gjallë.

Ah, po, do të flasim edhe për lulet, ndonëse në këtë kohë kanë mbetur vetëm ato brenda lokalit, lule serrash të prodhuara në seri. Gjithsesi është mirë të flasësh për lulet në vjeshtë, pasi kjo të jep shpresë për pranverën.

Mbeten pak metra. Muret kanë rënë plotësisht. Kam rilindur.



U afrova dhe e përshëndeta sipas zakonisht zviceran, tri herë të puthura faqe më faqe (sa herë jam jashtë vendit dhe e bëj këtë zakon njerëzit sikur

çuditen). E dallova sa nervoz ishte dhe i thashë të shkonim në verandë ku kemi më shumë privatësi dhe ai mund të pijë cigare. Kamerieri duket se e njeh. Jakobi kërkoi Kampari me tonik dhe unë çaj, siç e kisha menduar më parë.

Që ta ndihmoja të çlirohej fillova bisedën për natyrën, për pemët dhe bukurinë që fal e gjitha kjo stinë ku ka ndryshime të vazhdueshme. E pse të ruajmë gjithnjë të njëjtën normë? E pamundur, e panatyrshme! A nuk do të ishte më mirë që këto sfida t'i shihnim si burim njohjeje dhe jo si armiket tona?

Ai vazhdon nervoz dhe përgjigjet në mënyrë mekanike, sikur donte ta mbyllte bisedën, por unë nuk e lë. Ishte një ditë e veçantë në jetën time dhe si e tillë duhej respektuar. Vazhdoj të flas për gjëra që pashë tek erdha rrugës për në lokal, fjalë të tilla që, siç thashë më parë, nuk i kontrolloja. Habitem edhe si rrjedhin nga goja ime me aq saktësi.

Fola për kafshët shtëpiake, duke e pyetur se ç'mendon ai për faktin që njerëzit i duan aq shumë. Jakobi më dha një farë përgjigje të zakonshme dhe unë u hodha në tjetër temë, në atë se përse është kaq e vështirë të pranohet se njerëzit janë kaq të ndryshëm nga njëri-tjetri? Pse bëhen kaq ligje duke synuar krijimin e grupeve të tjera, ndërkohë që na duhet thjesht të pranojmë se dallimet kulturore e

pasurojnë jetën tonë dhe e bëjnë më interesante? Por ai ma preu duke më thënë se është i lodhur të flasë për politikë.

Atëherë le të flasim për një akuarium që e pashë sot tek shkolla e fëmijëve të mi, kur i çova në mëngjes. Atje brenda kishte një peshk që vinte rrotull e përplasej te qelqi, ndërsa unë mendoja: ai nuk e di i shkreti se ku e filloi xhiron dhe nuk do ta gjejë fundin. Ja, prandaj na pëlqejnë peshqit në akuarium, pasi ata na kujtojnë jetën që bëjmë, ashtu të ushqyer mirë, por nuk mund të kapërcejnë muret e qelqta.

Ai ndez edhe një cigare, ndërsa unë vura re që kishte dy bishta të shuar në tavëll. Në atë kohë kuptova se kisha shumë kohë që po flisja, madje në një trans drite e qetësie, pa i dhënë mundësi të shprehej se çfarë ndiente.

- Për çfarë do doje të flisje?

- Për atë fotografinë që më the, - m'u përgjigj me kujdes, pasi e vuri re që isha në një moment të ndjeshëm.

- Ah, fotografia. Sigurisht që ekziston! Është gdhendur me zjarr e hekur në zemrën time dhe unë mund ta shuaj kur të më lejojë Zoti. Por hyr më mirë dhe shiko me sytë e tu, sepse të gjitha barrierat që mbronin zemrën time u zhdukën ndërkohë që të afrohesha ty. Jo, mos më thuaj se



nuk e njeh këtë udhë, sepse nëpër të ke kaluar disa herë, si në të kaluarën, ashtu edhe tani. Ndërsa unë refuzoja të pranoja një gjë të tillë dhe e kuptoj që je ngurues. Jemi njësoj, pra mos u shqetëso se të drejtoj unë.

Pasi i thashë të gjitha këto, ai më mori dorën, pastaj qeshi dhe e bëri grusht:

- Nuk jemi më adoleshentë. Je një njeri i mrekullueshëm dhe me sa di ke një familje të bukur. A ke menduar ndonjëherë të bësh një terapi në çift?

Një moment mbeta e habitur. Ndërkohë u ngrita dhe eca drejt makinës sime, ashtu pa lot në sy, pa thënë lamtumirë, pa e kthyer kokën pas.

Nuk ndieja asgjë; nuk mendoja për asgjë. Shkova drejt tek makina ime dhe u nisa për rrugë, pa e ditur ku shkoj. Askush nuk më pret në fund të rrugës. Melankolia u kthye në apati. Më duhet të tërhiqem zvarrë për të bërë përpara.

Kështu deri sa pesë minuta më pas kam përballë një kështjellë. Unë e di se ç'ka ndodhur atje. Dikush i dha jetë një demoni të njohur deri në ditët tona, ndonëse janë të pakët ata që e dinë emrin e gruas që e lindi. Më mirë të ulem në një stol të ftohtë e të përfytyroj se çfarë ndodhi më 1817. Kam nevojë të humbas mendjen, madje të harroj se çfarë më frymëzonte më parë dhe të përqendrohem në diçka tjetër.

Përfytyroj një ditë të atij viti, kur banori i saj, poeti anglez Lord Bajroni vendosi të emigronte për këtu. E urrenin si në vendin e vet, ashtu edhe në Gjenevë, ku e akuzonin se organizonte orgji dhe dehej në publik. Ndërkohë ai vetë po vdiste

nga pakënaqësia. Ose nga melankolia. Ose nga zemërimi.

Pak rëndësi ka. E rëndësishme është që një ditë të vitit 1817 i erdhën nga vendi i tij dy miq. Poeti tjetër, Percy Bysshe Shelli bashkë me të shoqen 18-vjeçare, Meri.

Një i katërt i ftuar gjithashtu, por që nuk i a mbaj mend emrin, iu bashkua grupit.

Duhet të kenë folur për letërsinë, do të jenë ankuar për kohën me shira e të ftohtë, për banorët e Gjenezës, për bashkatdhetarët e tyre, për mungesën e çajit dhe uiskit. Ndoshta lexuan poezi, secili të vetat e pastaj u kënaqën duke lëvduar njëri-tjetrin.

U dukej vetja kaq të veçantë e të rëndësishëm sa që vunë edhe një bast: duhej të mblidheshin edhe një herë tjetër këtu brenda vitit, por secili duhej të sillte një libër të vetin mbi gjendjen njerëzore.

Me siguri që, pasi kaloi entuziazmi i planeve dhe komenteve se si qenia njerëzore është e tëra një lajthitje, ata harruan edhe premtimin që kishin bërë.

Në këtë bisedë ishte e pranishme edhe Meri. Nuk e bënë pjesë të bastit të vënë, së pari sepse ishte grua dhe, për më tepër, se ishte e re në moshë. Një gjë e tillë, gruan e re duhet ta ketë lënduar shumë. E pse të mos shkruante diçka për të kaluar kohën?

Temën e kishte dhe i mbetej vetëm ta zhvillonte, ndërsa pasi ta kishte përfunduar librin do ta ruante sekretet për vete.

Ndërkohë kur u kthyen në Angli, Shelli e lexoi dorëshkrimin dhe e inkurajoi që ta botonte. Për më tepër, meqë ai vetë ishte i famshëm, vendosi t'ia paraqiste një botuesi dhe të bënte edhe parathënien e librit. Meri ishte kundër botimit, por më në fund pranoi me një kusht: emri i saj nuk duhej vënë në kapakun e librit.

Botimi i parë më pesëqind kopje u shit shumë shpejt. Meri mendoi se kjo ndodhi për arsye të parathënies që kishte shkruar Shelli, prandaj në botimin e dytë e vuri emrin e saj si autore. Që prej atij çasti, në të gjitha libraritë e botës libri u shit me emrin e saj. U frymëzuan shkrimtarët, regjisorët e teatrit, drejtorët e kinemave, teksa u shfaq edhe në festat e Halluinëve, apo në ballot me maska. Madje, kohët e fundit u analizua edhe nga një kritik i shquar letrar si “punimi më krijues i romantizmit, apo ndoshta i dyqind viteve të fundit”.

Askush nuk di të thotë përse. Shumica nuk e lexoi kurrë, por në fakt tërë bota dëgjoji të flitet për të.

Tregohet historia e Viktorit, një shkencëtari zviceran i lindur në Gjenevë dhe i edukuar nga prindërit që ta kuptonte botën përmes shkencës.

Ende i vogël, ai vuri re se një vetëtimë ra mbi lis dhe djali pyeti veten: a thua të vijë jeta prej kësaj? Mos është njeriu vetë që krijon gjendjen humane?

Dhe si një version modern i Prometeut, figurës mitologjike që rrëmbeu zjarrin nga qiejt për të ndihmuar njeriun - autorja e përdor “Prometeun modern” si nëntitull, por askush nuk e fikson këtë, - fillon të punojë për të përsëritur veprën e Zotit. Sigurisht që, me gjithë përkushtimin, eksperimenti i del nga kontrolli.

Titulli i librit: *Frankenstein*.



O Zot që të mendoj nga pak për çdo ditë, por që besoj aq shumë kur kam hall, a thua të kem ardhur këtu rastësisht? Të jetë vallë dora jote e padukshme dhe e patundur që më solli në këtë kështjellë dhe bëri që të më vijë ndër mend kjo histori?

Meri e njohu Shellin kur ishte 15 vjeç dhe megjithëse ai ishte i martuar, ajo nuk i mori parasysh rregullat e shoqërisë, por i shkoi pas burrit që mendonte se ishte dashuria e jetës së saj.

Pesëmbëdhjetë vjeç! Madje e dinte shumë mirë se çfarë donte dhe si mund ta arrinte. Unë jam 31 vjeç dhe, çdo çast, dëshiroj diçka që jam e pa aftë

ta arrij, ndonëse mund të eci një pasdite të tërë vjeshte plot melankoli dhe romantizëm, frymëzuar nga ajo që do ta them kur të vijë koha.

Nuk jam Meri Shelli. Jam Viktor Frankenstein dhe përbindëshi i tij. U përpoqa t'i jap frymë një gjëje të pajetë dhe rezultati do të jetë ashtu si ai i librit në fjalë: përhapet tmerr e shkatërrim.

Nuk ka më lot. Nuk ka më dëshpërim. Ndihem sikur zemra ime të ketë hequr dorë nga gjithçka dhe trupi e pasqyron këtë, sepse nuk jam në gjendje të lëviz. Është vjeshtë, mbrëmja do të bjerë së shpejti dhe atij perëndimi të bukur të diellit ia zë vendin muzgu. Bie nata dhe jam ende e ulur aty duke parë kështjellën dhe vizitorët e saj, të cilët skandalizuan Gjenevën e shekullit XIX.

Ku të jetë vetëtima që i dha jetë përbindëshit?

Nuk e gjej. Trafiku, që është i pakët në këtë zonë, bëhet edhe më i rrallë. Fëmijët presin darkën dhe im shoq që e di gjendjen time, shumë shpejt do të shqetësohet. Por unë duket sikur kam një gjyle hekuri lidhur pas këmbëve dhe nuk jam ende në gjendje të lëviz nga vendi.

Jam një humbëse.

**A** mundet që dikush të jetë i detyruar të kërkojë falje sepse zgjoi një dashuri të pamundur?

Jo, në asnjë mënyrë.

Sepse edhe dashuria e Zotit për ne është e pamundur. Asnjëherë nuk merr përgjigjen që meriton, por megjithatë Ai vazhdon të na dojë. Madje na deshi aq shumë, sa që na dërgoi birin e tij të vetëm për të na treguar se dashuria është forca që lëviz diellin dhe yjet. Në një nga predikimet e Korinthit, të cilën na detyronin ta mësonim përmendësh në shkollë, apostulli Paulo thotë:

*Edhe sikur ta flisja gjuhën e njerëzve dhe atë të engjëjve, po të mos kisha dashuri do të isha si bronzi që kumbon ose si dy pjatat metalike të bandës së qytetit, të cilat ushtojnë kur përplasen me njëra-tjetrën.*

Të gjithë e dimë përse. Shumë herë na bie të dëgjojmë ato që duken si ide të mëdha, të cilat do të ndryshonin botën, por që janë veç fjalë të thëna

pa emocion, të zbrazëta nga dashuria. Sado të mençura e logjike të duken, ato nuk na prekin.

Paulo e krahason Dashurinë me Profecinë, me Misteret, Besimin dhe Bamirësinë. Përse Dashuria është më e rëndësishme se Besimi?

Përse Besimi është vetëm një rrugë që na çon tek Dashuria Sublime?

Përse Dashuria është më e rëndësishme se Bamirësia?

Përse Bamirësia është vetëm një shprehje e Dashurisë?

Dhe kështu e tëra është më e rëndësishme se njëra pjesë. Nga ana tjetër, edhe Bamirësia është veç një prej rrugëve të shumta që përdor Dashuria, në mënyrë që njerëzit të lidhen me të afërmit e tyre.

Të gjithë e dimë se ka edhe bamirësi pa dashuri. Për çdo jave ka nga një ballo “bamirësie” rreth e rrotull. Njerëzit paguajnë shumë për të zënë një tavolinë qysh më parë, pastaj marrin pjesë dhe dëfrenë veshur me rroba të shtrenjta e mbushur me stoli. Kur dalim prej andej, mendojmë se bota do të jetë më e mirë me ato paratë e grumbulluara aty për të pastrehët në Somali, të dëbuarit e Jemenit, apo ata që janë të uritur në Etiopi. Nuk ndihemi, pra, edhe fajtorë për atë spektakël të tmerrshëm mjerimi, por asnjëherë nuk e pyesim veten se ku shkojnë këto shuma parash.



Ata që nuk i kanë mundësitë të shkojnë në ballo të tilla, apo që nuk kanë të ardhura bankare për të bërë gjeeste ekstravagante, kalojnë pranë një lypësi dhe i lëshojnë një monedhë. Eh, është shumë lehtë të hedhësh një monedhë në rrugë për lypësin, madje më e lehtë se sa të mos ia hedhësh.

Çfarë lehtësimi në shpirt për vetëm një monedhë! Diçka që nuk na kushton neve dhe që zgjidh problemin e lypësit.

Në fakt, po ta donim, do të bënim shumë më tepër për të.

Ose nuk do të bënim asgjë. Kështu që nuk do t'ia jepnim monedhën dhe kush e di, ndoshta një ndjenjë faji për atë mjerim do të na zgjonte Dashurinë e vërtetë.

Paulo e krahason Dashurinë me sakrificën dhe martirizimin.

Tani i kuptoj më mirë fjalët e tij. Edhe po të isha gruaja më e suksesshme në botë, më e adhuruar dhe e dëshiruar se Zonja Konig, po të mos ndieja dashuri në shpirt, asgjë nuk do të kishte vlerë. Asgjë.

Në intervistat me artistë e politikanë, mjekë apo asistentë socialë, me studentë dhe nëpunës publikë, gjithmonë u drejtoj pyetjen: “Cili është objektivi i punës suaj?” Disa më përgjigjen: ja, të krijoj një familje; të tjerë më thonë: të bëj karrierë; por

teksa shtyhem më tej në këtë pyetje, më përgjigjen mekanikisht: të përmirësojmë botën.

Dua të shkoj tek Pont Montblanc, Ura Montblanc, me një parullë të shkruar me germa të praruara dhe t'ia jap çdo makine që kalon aty. Në të do të shkruaja:

*“Ju lutem të gjithë atyre që do të duan të punojnë një ditë për të mirën e njerëzimit: kurrë mos harroni se sikur edhe në zjarr të digjeni në emër të Zotit, po nuk ndjetë Dashuri, nuk do të kishte fare vlerë. Hiç fare!”*

Nuk ka gjë më të rëndësishme që mund të dhurojmë se sa reflektimi i Dashurisë në jetën tonë. Ajo është gjuha vërtetë universale që na lejon të flasim edhe kinezisht, apo dialektet e Indisë. Në rininë time udhëtoja shumë, pasi ishte pjesë e ritit të jetës studentore. Pashë vende të pasura e të varfra, ndonëse në shumë udhëtime nuk e dija gjuhën e vendit. Gjithsesi, kudo që shkova, elokuenca e heshtur e Dashurisë më ndihmoi të merrem vesh.

Mesazhi i dashurisë qëndron në mënyrën se si jeton dhe jo tek fjalët apo aktet.

Në meshën për Korinthisit me tre vargje të shkurtër, Paulo na thotë se Dashuria është e përbërë nga të tjera gjëra, ashtu si edhe drita. E kemi mësuar në shkollë që po morëm një prizëm dhe e vendosim atje ku e përshkon një rreze dielli, kjo rreze zbërthehet në ngjyrat e ylberit.

Paulo na mëson se ylberi i Dashurisë, ashtu si prizmi kur e përshkon rrezja e diellit, na tregon ylberin e dritës.

Cilët qenkan këta elementë? Janë virtytet, për të cilat dëgjojmë të flitet çdo ditë dhe që mund t'i praktikojmë në çdo moment.

Durimi: *Dashuria është e duruar.*

Mirësia: *Përherë dashamirëse.*

Shpirtmadhësia: *Dashuri që nuk vlon në xheloz.*

Thjeshtësia: *Nuk mburret, nuk krenohet.*

Delikatesa: *Dashuria nuk sillet në mënyrë të papërshtatshme.*

Përkushtimi: *Nuk sheh interesat e veta.*

Toleranca: *Nuk mërzitet.*

Pafajësia: *Nuk mban inat.*

Sinqeriteti: *Nuk pajtohet me padrejtësinë, por i gëzohet së vërtetës.*

Të gjitha këto dhunti lidhen me jetën tonë të përditshme, me të sotmen dhe të nesërmen, me Përjetësinë.

Problemi i madh është se njerëzit i lidhin ato vazhdimisht me dashurinë për Zotin. Po si manifestohet dashuria për Zotin? Përmes dashurisë për njeriun.

Për të gjetur paqen në qiell duhet të takosh dashurinë në tokë. Pa të nuk kemi asnjë vlerë.

Unë dashuroj dhe askush nuk mund të ma marrë këtë. E dua tim shoq, i cili gjithnjë më ka

mbështetur. Besoj gjithashtu se e kam dashur dikë që e njoha në adoleshencë. Teksa ecja drejt tij, një pasdite të bukur vjeshte, i lashë të binin përtokë të gjitha mburojat e mija dhe nuk arrij t'i ribëj. Jam e brishtë, por nuk më vjen keq për këtë.

Sot në mëngjes, ndërkohë që pija një filxhan çaj, vura re një dritë të butë që vinte nga jashtë, çka bëri të kujtoj tërë këtë rrugëtim dhe e pyeta veten për herë të fundit: a mos po krijoj një problem real për të larguar problemet imagjinare? Jam vërtet e dashuruar, apo vetëm i transferova ndjesitë e pakëndshme të muajve të fundit tek një fantazi?

Jo, Zoti nuk është i padrejtë dhe nuk do të lejonte kurrë që unë të dashurohem në këtë mënyrë nëse nuk mund të ishte e dyanshme.

Ndërkaq, nganjëherë dashuria kërkon që të luftosh për të. Ja, këtë do të bëj edhe unë. Në kërkim të drejtësisë do ta largoj të keqen duke shmangur zemëratën dhe padurimin. Kur Mariana të jetë larg dhe ai pranë meje, Jakobi do të më jetë mirënjohës për gjithë jetën.

Ndoshta edhe do të ikë, por tek unë do të mbetet ajo ndjenja që tek e fundit bëra ç'ishte e mundur.

Jam një grua e re në moshë dhe po kërkoj diçka që nuk vjen vetë e në mënyrë të rastësishme. Ai

është i martuar dhe beson që çdo hap i gabuar mund ta dëmtojë karrierën e tij.

Atëherë, ku duhet të përqendrohemi? T'ia prish martesën pa e marrë vesh.

**M**ë duhet të takoj për herë të parë një trafikant!

Jetoj në një vend që ka vendosur të jetë i izoluar nga bota dhe ndihet i kënaqur me këtë. Kur viziton fshatrat përreth Gjenevës, të bie menjëherë në sy që nuk ke se ku të parkosh makinën, veçse në garazhin e ndonjë të njohuri atje.

Mesazhi është: ti i huaj mos eja këtu, pasi pamja atje poshtë e liqenit, madhështia e Alpeve në horizont, lulet e fushës në pranverë dhe ngjyrat e praruara të vreshtave në vjeshtë, gjithçka është një pasuri që na e kanë lënë të parët tanë, të cilët jetuan këtu të patrazuar kurrë. Kështu duam që të vazhdojë, prandaj ti o i huaj mos eja. Edhe sikur të kesh lindur e të jesh rritur në një qytet fqinjë, as nuk duam të dimë se çfarë mund të na tregosh. Po deshe të parkosh makinën, gjej një qytet të madh, plot me vende të caktuara për këtë.

Jemi aq të izoluar nga bota, sa ende besojmë në rrezikun e një lufte të madhe bërthamore. Është

detyrim që çdo ndërtesë të ketë edhe strehimin e vet antibërthamor. Madje, kohët e fundit, një deputet deshi të anulohet ky ligj, por Parlamenti ishte kundër: po, ndoshta kurrë nuk do të kemi një luftë bërthamore, por si të bëjmë kundër kërcënimit të armëve kimike? Duhet mbrojtur qytetet tona, prandaj edhe të dashurat strehime antibërthamore vazhdojnë të ndërtohen. Madje, ato kthehen në kantina pijesh e në depo për sa kohë që Apokalipsi nuk duket.

Ndërkaq ka gjëra që, me gjithë përpjekjet tona për të mbetur një ishull paqeje, nuk arrijmë t'i pengojmë që të kapërcejnë kufirin tonë.

Të tilla janë drogat, për shembull.

Qeveritë tona përpiqen të kontrollojnë pikat e shitjeve dhe mbyllin sytë ndaj blerësve. Ndonëse jetojmë në një parajsë, a nuk stresohemi të gjithë për trafikimin, për përgjegjësitë, për afatet dhe bezditë? Drogat stimulojnë prodhimtarinë (sikurse kokaina) dhe ulin tensionin (si hashashi). Prandaj, që të mos jemi një shembull i keq për botën, ne edhe i ndalojmë, por njëherazi edhe i lejojmë ato.

Ndërkohë, sa herë që problemi fillon të marrë përmasa të mëdha, për “koincidence” ndonjë figurë e njohur apo person publik kapet me “lëndë narkotike”, sikurse e themi ne në gjuhën gazetareske. Rasti buçet në media për t'u bërë

shembull, për të shkurajuar të rinjtë, për t'i thënë popullit se qeveria ka gjithçka nën kontroll, pra është më këmbë ndaj atyre që nuk i binden ligjit!

Kjo ndodh të paktën një herë në vit dhe nuk e besoj që vetëm një herë në vit, dikush i rëndësishëm del nga rutina dhe shkon tek kalimi i nëndheshëm i Urës Montblanc, për të blerë atë që trafikantët e kanë me bollëk çdo ditë. Po të ishte kështu, këta të fundit do të ishin zhdukur apo larguar që andej për mungesë blerësish.

Mbërrita në vend. Njerëzit venë e vijnë, por tipat e dyshimtë janë po aty, pa u shqetësuar e pa turbulluar të tjerët, përveçse kur kalon një çift të rinjsh ku dëgjohet të flasin një gjuhë të huaj, ose kur ndonjë uniformë zyrtare kalon kanalën dhe kthehet e i vështron ngultas në sy.

Kalova herën e parë dhe hidhem në anën tjetër, pastaj bleva një ujë mineral dhe i qahem për të ftohtit dikujt që nuk e kisha parë kurrë. Ajo, e zhytur në botën e saj, nuk m'u përgjigj fare. U ktheva, ndërsa ata burrat ishin po aty. Shkëmbyem vështrimet tona, por po kalojnë shumë njerëz, ashtu si rrallë herë ndodh. Është koha e drekës dhe njerëzit duhet të ishin nëpër restorantet e shtrenjta në qytet, ose duke u përpjekur të mbyllin ndonjë marrëveshje të rëndësishme, apo të bindin dikë që sapo ka ardhur në qytet në kërkim të një pune.